

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

FAKULTETI I GJEOLOGJISË DHE I MINIERAVE

ATLASI I BURIMEVE TË ENERGJISË GJEOTERMALE NË SHQIPËRI

ATLAS OF THE GEOTHERMAL RESOURCES IN ALBANIA

TIRANE, 2004

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I GJEOLOGJISË DHE I MINIERAVE

ATLASI I BURIMEVE TË ENERGJISË GJEOTERMALE NË SHQIPËRI

MONOGRAFI

ATLAS OF GEOTHERMAL RESOURCES IN ALBANIA

Tiranë, 2004

AUTORËT
AUTHORS

Prof. Dr. Alfred Frashëri* & Dr. Vladimir Çermak**.
(Bashkëdrejtues të projekteve – Co-coordinators of the Projects),
Prof. Dr. Muhamet Doracaj*
Prof. Dr. Rushan Liço*
Dr. Jan Safanda**
Dr. Fiqiri Bakalli*
Dr. Milan Kresl**
Dr. Nazif Kapedani***
Dr. Peter Stulc**
Dr. Esat Malasi*
Ing. Burhan Çanga*
Ing. Hilmi Halimi*
Ing. Edlir Vokopola*
Ing. Lenka Kuçerova**
Ing. Enkeleida Jareci*

GRUPI SHKENCOR I PËRGATITJES SË ATLASIT PËR BOTIM
EDITORING TEAM

Prof. Dr. Alfred Frashëri
(Kryeredaktor, Editor-in-chief),
Prof. Dr. Rushan Liço
Dr. Fiqiri Bakalli
Prof. Dr. Neki Frashëri
Prof. Dr. Niko Pano
Prof. Dr. Salvatore Bushati
Prof. Dr. Bashkim Çela
Prof. Dr. Ëngjell Prenjasi
Prof. As. Dr. Hajri Haska
Inxh. Burhan Çanga

Redaktore e gjuhës shqipe:
Tatjana Cenko

Përgatitur grafikët për botim:
Informatikan Dashamir Hoxha

Art GRAFIK:
Ing. Agron Pullumbi

* Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave, Universiteti Politeknik i Tiranës.
** Instituti i Gjeofizikës, Akademia e Shkencave, Pragë, Republika Çeke.
*** Instituti Gjeologjik i Naftës dhe i Gazit, Fier.

* Faculty 0f Geology and Mining, Polytechnic University of Tirana.
** Geophysical Institute, Academy of Sciences, Praha, Czech Republic.
*** Geological Institute of Oil and Gas, Fier.

“Ne dëshirojmë të theksojmë se duhet të realizohet qëllimi për dyfishimin e kontributit të energjive të rinovueshme në dhjetë vitet e ardhëshme, duke kërkuar impaktin e plotë të energjisë gjeotermale, si për gjenerimin e energjisë elektrike ashtu edhe për ngrohje.... Burimet gjeotermale mund të përbëjnë një kontribut të rëndësishëm për të reduktuar varësinë nga importi i lëndëve djegëse, si edhe ngarkesën e mjedisit në disa vende të Evropës.....”

(Rezolucioni i Reykiavikut, 17 Nëntor1998, Programi i Pestë Kuadër i Bashkimit Europian)

“Mjedisi ynë na ofron dy burime për të plotësuar nevojat tona, Diellin dhe Tokën, tërësisht të ndryshëm. Dielli na jep energjinë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi: energjinë e erës, të ujit dhe të biomasës. Por Dielli është lozonjar; ai na bën të varur nga koha e ditës dhe e natës, nga moti dhe klima. Toka paraqet vështirësi, por është e sigurt: potenciali i saj është i gjendur në çdo kohë, ai vetëm duhet shfrytëzuar me teknologjinë e përshtatshme.”

(Deklarata e Ferrarës, Itali, 29-30 Prill 1999, Këshilli Europian i Energjisë Gjeotermale)

TREGUESI I LËNDËS

FAQE

Fig. 1. Harta skematike e subduksionit të pllakës afrikane nën atë të Evroazisë. [Sipas Ricou, E.L.. 1986].1- kontinenti evro-aziatik; 2- Kontinenti afrikan; 3- Blloku i Kishir-it; 4-Basenet Oqeanike të sotme; 5- Kufijtë e

Fleta 1-a. Struktura e Kores së Tokës dhe e Mantelit të sipërm, sipas studimeve sizmologjike [Të dhënat sipas Koçiu S., 1989].

Fleta 1-b. Skema tektonike e Shqipërisë. [Harta Tektonike e Shqipërisë, Shkalla 1:200 000, 1985].

Fleta 2. Harta e anomalive të gravitacionit, në reduksionin Buge. (Bushati S., 1988)

Fleta 3. Harta e fushës magnetike totale. (Bushati S., 1997)

Fleta 4-a. Profili gjeologo-gjeofizik Albanid-1: Falco në detin Adriatik-Durrës-Tiranë- Peshkopi. [Të dhënat e gravitacionit për detin Adriatik sipas Richetti, 1980]. 1. Pliocen (N_2), 2- Miocen i poshtëm (N_1)-flishi i paleogjenit (Pg_3); 3- Gëlqerorë mesozoikë (Mz); 4- Shkëmbinj ultrabazikë; 5- Kripëra; 6- Bazamenti kristalin; 7- Kore bazaltike; 8- Kufiri MOHO; 9- Thyerje e thellë; 10- Dendësia, g/cm^3; 11- Temperatura, ^{o}C; 12- Pus i thellë; ΔG_B- Anomalia Bouguer; T- Anomalia e fushës totale magnetike; q-Dendësia e fluksit të nxehtësisë.

Fleta 4-b. Profili gjeologo-gjeofizik Shkodër-Kukës. 1. Shkëmbinj efuzivë; 2- Shkëmbinj ultrabazikë; 3- Gabro; 4- Formacion sedimentar; 5- Tektonikë shkëputëse.

Fleta. 5. Prerje sizmike në zonën Jonike dhe në Ultësirën Pranadriatike. [Frasheri A., Bushati S., Bare V., 2003].

Fleta 6. Harta e puseve me matje temperature.

Fleta 7. Harta e temperaturës në thellësinë 100 m.

Fleta 8-a. Termograma të pusit Rinasi-1.

Fleta 8-b. Termograma e liqenit të Ohrit, zona Piskupat.

Fleta 8-c. Termograma e liqenit të Ohrit, zona Guri i Kuq.

Fleta 9. Harta e temperaturës në thellësinë 500 m.

Fleta 10. Harta e temperaturës në thellësinë 1000 m.

Fleta 11. Harta e temperaturës në thellësinë 2000 m.

Fleta 12. Harta e temperaturës në thellësinë 3000 m.

Fleta 13. Harta e gradientit gjeotermal mesatar.

Fleta 14-a. Profili gjeotermal Divjakë.

Fleta 14-b. Profili gjeotermal Kolonjë.

Fleta 14-c. Profili gjeotermal Ballsh.

Fleta 15-a. Profili gjeotermal Papër. Legjenda si në Fletën 14.

Fleta 15-b. Profili gjeotermal Kalcat. Legjenda si në Fletën 14.

Fleta 15-c. Kolonë gjeotermale Povelçë.

Fleta 15-d. Ndikimi i trysnisë mbinormale në fushën e temperaturës.[Liço R. etj. 1998]. 1. Temperatura, ^{o}C; 2- Resistenca e dukshme, x10^{-1} Omm; 3- Presioni, Mpa; 4- Ndryshimi i diametrit të pusit, %; TM- tavani i zonës me trysni mbinormale.

Fleta 16. Harta e dendësisë së fluksit të nxehtësisë.

Fleta 17. Harta tematike gjeotermale.

Fleta 18. Harta e burimeve gjeotermale dhe e epiqendrave të tërmeteve. [Të dhënat sizmologjike sipas Sulstarova E. etj. 1972].

Fleta 19. Harta e burimeve gjeotermale dhe e izoseisteve të tërmeteve. [Të dhënat sizmologjike sipas Sulstarova E. etj. 1972].

Fleta 20. Harta e Zonës Gjeotermale Kruja, (Pjesa veriore).

Fleta 21-a. Foto: Pusi gjeotermal Ishmi 1/b.

Fleta 21-b. Foto: Pusi gjeotermal Kozani-8. (Foto Arjan Gaçe)

Fleta 22-a. Skemë topografike, zona e burimeve gjeotermale Llixha Elbasan. (Avgustinsky V.L. 1957) 1. Olistolit gëlqeror; 2- Argjila; 3- konglomerate; 4- Shkëmbinj të kaolinitizuar; 5. Burim termal

Fleta 22-b. Foto: Zona e burimeve gjeotermale, Llixha Elbasan.

Fleta 23-a. Harta tektonike e zonës së burimeve gjeotermale Bënjë-Postenan- Sarandaporo. [Harta Tektonike e Shqipërisë, Shkalla 1:200 000, 1985]. 1. Depozitime kuaternare (Q_1 - Q_3); 2- Depozitime flishore oligocenike, tektonogjeneza e burdigalian-tortonianit; 3- Depozitime flishore oligocenike, tektonogjeneza e mbarimit të oligocenit të mesëm; 4- Gëlqerorë neritikë eocenike; 5- Depozitime flishore, tekonogjeneza e eocenit të vonshem; 6- Gëlqerorë të Kretakut të poshtwm, tektonogjeneza e kretakut të vonshëm; 7- Depozitime karbonatike të pa padiferencuara të triasikut të sipëm-jurasikut të poshtëm, tektonogjeneza e jurasikut të vonshëm; 8- Serpentinite; 9- kufi tektonik mbihipës; 10- Aks sinklinali; 11- Aks antiklinali; 12- Burim ujërash termale; 13- Burim avulli.

Fleta 23-b. Foto: Burimet gjeotermale Bënjë, lumi i Langaricës, Përmet.

Fleta 24-a. Foto: Tektonika në zonën e burimit të avullit, Mali i Postenanit, Leskovik.

Fleta 24-b. Foto: Thyerja tektonike nga buron avulli, Postenan.

Fleta 24-c. Foto:Zona e burimevet gjeotermale, Sarandaporo, Leskovik.

Fleta 25. Harta e zonës gjeotermale Ardenica. 1. Dalje e ujit të nxehtë; 2- Kufi moshor gjeologjik; 3- Kufi sizmik; 4. Tektonikë shkëputëse; 5- Sipërfaqja e shplarjes; 6- Molasa neogjenike (N_1^3-N_2); 7- Mergel e burdigalianit (N_1^b) – Flishoid i akuitanianit (N_1^a); 8- Flish oligocenik (Pg_3); 9- Gëlqerorë kretakë-eocenikë (Cr_2-Pg_{12}).

Fleta 26-a. Harta gjeologjike e zonës gjeotermale Peshkopia. [Sipas Harta Tektonike e Shqipërisë, Shkalla 1:200 000, 1985]. 1- Sedimente terrigjene të metamorfizuar, me ndërthurje vullkanogjenësh, të moshës ordovician-devonian; 2- Depozitime evaporitike triasike; 3- Formacione të tektonogjenezës të jurasikut të vonshëm: karbonate (T_1 dhe T_2-J) dhe konglomerate të serisë verukano (P-T_1); 4- Formacioni efuziv-sedimentar (T_{1-2}); 5- Flishi i hershëm (J_1-Cr_2^{cen}); 6- Formacioni flishor i eocenit të sipërm-oligocenit të poshtëm (Pg_2^3-Pg_3^1); 7- Ranorë-konglometate-mergele të pliocenit të vonshëm-kuaternarit (N_2-Q_{1-3}); 8- Burime termale; 9- Kufiri i diapirit evaporitik.

Fleta 26-b. Foto: Zona Gjeotermale Peshkopia, Përroi i Banjës, Peshkopi.

Fleta 27-a. Sistemi këmbyes vertikal nxehtësie-pus-pompë gjeotermale nxehtësie për ngrohjen e godinave.

Fleta 27-b. Ngarkesa vjetore e energjisë elektrike me dhe pa ngrohjen, 1999. (Agjencia Kombëtare e Energjisë).

Fleta 2. Foto: Qendrat Balneologjike Hotel Park dhe Hotel Hydrat në Elbasan Qendra Peshkopi, Sarandaporo (në rikonstruksion).

Fleta 29. Foto: Qendrat Balneologjike: Hotel Hydrat në Elbasan dhe e Sarandaporos (në rikonstruksion).

Fleta 30. Foto: Impakti mjedisor nga derdhja e ujërave termalë, Llixha Elbasan dhe Pusi Kozani-8 (b).

ATLASI I BURIMEVE TË ENERGJISË GJEOTERMALE NË SHQIPËRI

HYRJE

Monografia "**ATLASI I BURIMEVE TË ENERGJISË GJEOTERMALE NË SHQIPËRI**" botohet në kuadrin e Programit Kombëtar të Kërkim-Zhvillimit, Pasuri Natyrore, 2003-2005. Ai është përgjithësim i studimeve monografike të pabotuara ose të botuara pjesërisht, në kuadrin e Projekteve të Komitetit të Shkencës dhe Teknologjisë të Shqipërisë, të Komisionit Ndërkombëtar të Fluksit të Nxehtësisë dhe të Komisionit Europian, UNDP-GEF SMP Tiranë [1, 2, 3, 4, 5, 6].

Studimet-Atlase [2, 3, 4] janë rezultat i punës intensive disa vjeçare kërkimore shkencore të ekipit të përbashkët të Seksionit të Gjeofizikës në Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave, Universitetit Politeknik të Tiranës, të Institutit të Gjeofizikës së Akademisë së Shkencave të Republikës Çeke, dhe të Institutit Gjeologjik të Naftës dhe të Gazit, Fier. Ekipi përbëhej nga shkencëtarë dhe specialistë shqiptarë e çekë, të profesioneve të lidhur me gjeoterminë, si: gjeofizikë e gjeotermistë, gjeologë dhe hidrogjeologë, fizikanë dhe gjeodetë.

Përgatitja e monografisë për botim është bërë nga grupi shkencor: Prof. Dr. Alfred Frashëri (kryeredaktor), Prof. Dr. Rushan Liço, Dr. Fiqiri Bakalli, Prof. Dr. Neki Frashëri, Prof. Dr. Niko Pano, Prof. Dr. Salvatore Bushati, Prof. Dr. Bashkim Çela, Prof. Dr. Ëngjëll Prenjasi, Prof. As. Dr. Hajri Haska, Inxh. Burhan Çanga, informatikan Dashamir Hoxha.

Atlasi do të krijojë bazën shkencore të përdorimit dhe shfrytëzimit kompleks dhe kaskadë të energjisë gjeotermale në Shqipëri, si dhe do të japë ndihmesë modeste në bilancin energjetik të vendit.

Falënderime

Janë bërë konsultime dhe janë zgjidhur probleme të veçanta edhe në bashkëpunim me ekipin gjeotermik të Universitetit Lorand Etvesh të Budapestit Dr. Luiza Bodri, të Universita degli Studi di Bari, Dipartimento di Geologia e Geofisica Prof. Francesco Mongelli dhe Prof. Gianmaria Zito dhe me Prof. Michail Fytikas i Universitetit Aristoteli i Thesselanikut. Të gjithëve atyre u shprehim falënderimet më të përzemërta. Për realizimin e studimeve të gjeotermisë kemi patur mbështetjen dhe ndihmën e pakursyer, si edhe bashkëpunim të frytshëm me Institutin e Informatikës dhe të Matematikës së Aplikuar (INIMA), dhe veçanërisht të Prof. Dr. Akademik Gudar Beqiraj dhe Prof. Dr. Neki Frashëri, të cilëve u shprehim mirënjohjen tonë. Falënderojmë Prof. Dr. Geys Mebu A. në Niedersachsisches Landesamt Fur Bodenforschung, Hannover, për analizat e tritiumit dhe të Oksigjenit 18 dhe Dr. Jovan Zoto, Instituti i Fizikës Bërthamore në Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë, për analizat e izotopit të Oksigjenit 18.

I jemi mirënjohës botuesve Dr. E. Hurtig, Dr. Vladimir Çermak, Dr. Ralf Haenel. dhe Dr. Vladimir Zui of the GEOTHERMAL ATLAS OF EUROPE, si edhe Dr. Suzanne Hurter dhe Dr. Ralph Haenel të "ATLAS OF GEOTHERMAL RESOUCES IN EUROPE" për konsultimin dhe udhëzimet me shumë vlerë që na ka dhënë në procesin e hartimit të Atlasit. Falënderojmë Dr. Andrew Green, Drejtor i Manaxhimit i CSMA Ltd. për ndihmën dhe kujdesin e vazhduar, si edhe BSc DMS Haydn Scholes, ITG Manaxher i CSMA Ltd. për diskutimin dhe vlerësimin që i bëri punës sonë gjatë paraqitjes së hartave gjeotermale të Shqipërisë.

Ne u shprehim falënderimet tona Zotit Arjan Gace, UNDP-GEF SGP Zyra e Tiranës, Prof. Dr. Kiril Popovski, Universiteti St. Kliment Ohridski, Bitola dhe Prof. John V. Lund, Instituti i Teknologjisë, Oregon USA për kontributin e tyre dhe ndihmën lidhur me studimin për rrugët e shfrytëzimit të energjisë gjeotermale, miqësore me mjedisin, në Shqipëri, që kemi relizuar vitet e fundit.

Në mënyrë të veçantë falënderojmë Drejtorinë e Zbatimit të Programeve dhe Projekteve të Komitetit të Shkencës dhe të Teknologjisë, Dekanatin e Fakultetit të Gjeologjisë dhe të Minierave të Universitetit Politeknik të Tiranës, Zyrën e GEF-UNDP në Tiranë, Drejtorinë e Institutit Gjeofizik të Akademisë së Shkencave të Republikës Çeke në Pragë dhe të Institutit Gjeologjik të Naftës dhe të Gazit, të Albpetrol në Fier, Departamentin e Gjeotermisë dhe Laboratorin e Kimisë së Institutit Leibniz për Gjeoshkencat e Zbatuara (GGA), Hannover, Gjermani, UNDP-GEF SGP Zyra e Tiranës Drejtorinë e Institutit të Informatikës dhe të Matematikës së Aplikuar (INIMA) për ndihmën e vazhdueshme të dhënë gjatë hartimit të Atlaseve dhe kushtet e krijuara për realizimin e projekteve përkatës të fushës së gjeotermisë.

Përzemërsisht falënderojmë Zotin Andrew McLeish për korrigjimin gjuhësor të përmbledhjes në gjuhën angleze, si edhe Zonjën Tatjana Cenko për redaktimin gjuhësor të tekstit në gjuhën shqipe. I shprehim mirënjohjen Ing. Agron Pullumbi për punën e kualifikuar që ka bërë në përgatitjen për shtyp të monografisë.

Autorët falenderojnë recenzentët Prof.Dr. Gjergji Foto dhe Prof.As.Dr. Pirro Leka për vlerësimin që i bënë monografisë dhe ndihmesën që ata dhanë me sugjerimet e bëra.

I shprehim mirënjohjen Drejtorisë së Shkencës së Ministrisë së Arsimit dhe Shkencave, Kryesisë së Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë dhe Dekanatit të Fakultetit të Gjeologjisë dhe të Minierave të Universitetit Politeknik të Tiranës, për krijimin e kushteve për botimin e "Atlasi i Burimeve të Energjisë Gjeotermale të Shqipërisë".

I. STUDIMI GJEOTERMAL I SHQIPËRISË

1. STUDIMET GJEOTERMALE PARAPRIJËSE TË ATLASIT

Studimet gjeotermale të kryera në kuadrin e realizimit të projekteve “Atlasi Gjeotermal i Albanideve” [1995] dhe “Atlas of the Geothermal Resources in Albania” [1996], janë paraprirë nga matje të temperatures në puse të thellë të naftës dhe të gazit. Këto matje janë kryera qysh nga viti 1951, nga operatorët e parë të karotazhit, si: Hamdi Bejtja, Alfred Frashëri, Agim Luari, Pertef Nishani, Kadri Zalla etj., të Ekipit të Karotazhit të Ndërmarjes së Shpimit në Patos dhe më pas nga operatorët Fatmir Luari, Zylal Mahmutaj etj., të Ndërmarrjes së Gjeofizikës Kantierale të Patosit. Nga këto institucione, temperatura është regjistruar me termometra elektrikë në qindra puse të thellë nafte dhe gazi për të përcaktuar nivelin e ngritjes së unazës së çimentos pas kolonës dhe për të zgjedhur detyra të tjera të ndryshme të karakterit teknik. Në 85 puse është regjistruar temperatura për përcaktimin e gradientit gjeotermal. Gjatë viteve, specialistë të ndryshëm të Ndërmarrjes së Gjeofizikës Kantierale të Patosit, Vladimir Dodbiba, Fejzi Kafexhiu, Daver Çano etj., kanë studiuar dhe përgjithësuar regjistrimet e kryera të temperaturës.

Në disa puse në vendburime të naftës dhe të gazit është matur temperatura edhe me termometra maksimale në disa thellësi, nga specialistë të ndërmarrjeve të nxjerrjes së naftës dhe të gazit dhe të Institutit Teknologjik të Naftës dhe Gazit në Patos.

Në vitin 1990, u krye studimi “Gjeotermia e Albanideve” [A.Frashëri], i cili u përfshi në Atlasin Gjeotermal të Europës, 1992, i botuar nga Geographisch-Kartographische Anstalt Gotha në Gjermani. Hartat gjeotermale të Shqipërisë në këtë Atlas janë dhënë në shkallën 1:2500000 dhe janë ndërtuar sipas analizës së 38 termogramave.

Në gjashtëmujorin e dytë të vitit 1992, filloi realizimi i Projektit “Gjeotermia e Albanideve”, fryt i të cilit është Atlasi Gjeotermal i Shqipërisë (1995) me të dy pjesët e tij, atë tërësor për Shqipërinë, me harta në shkallën 1:1000000 dhe tjetrin për zonën tektonike Jonike dhe Ultësirën Pranadriatike ku ndodhen vendburimet e naftës dhe të gazit [1993] me harta në shkallën 1:1500000.

Atlasi është hartuar duke patur në dispozicion termogramat:

- E 84 puseve të regjistruara nga ekipet e Ndërmarrjes Gjeofizike Kantierale të Patosit, për periudhën 1952-1993.
- E 59 puseve të regjistruara nga ekipi i Seksionit të Gjeofizikës të Fakultetit të Gjeologjisë dhe të Minierave, si edhe në bashkëpunim me shkencetarët çekë në periudhën 1993-1995.

Vetitë termike të shkëmbinjve, sipas mostrave të mbledhura në vitet 1993-1995 në Shqipëri, janë përcaktuar nga ekipi shqiptar në Laboratorin e Institutit Gjeofizik të Pragës dhe disa në Departamentin e Gjeologjisë dhe të Gjeofizikës në Universitetin e Barit.

Matjet në miniera, në Bulqizë, etj. janë kryer nga Doc. Hajredin Shtino.

Studimi "Atlas of Geothermal Resources of Albania" u hartua gjatë viteve 1994-1996 nga i njëjti ekip i përbashkët shqiptaro-çek në kuadrin e "Atlas of Geothermal Resources in Europe", i cili u botua në vitin 2002.

Platforma mbi parimet e përdorimit kompleks dhe kaskadë të energjisë gjeotermale të entalpisë së ulët në Shqipëri, e përgatitur nga Alfred Frashëri gjeti vlerësim nga Workshopi 26-të mbi Inxhinjerinë e Rezervuarëve Gjeotermalë (29-31 janar 2001) Universiteti Stanford California, USA dhe u botua në materialet e tij.

Vrojtimet, studimet dhe analizat e burimeve dhe të puseve të ujërave termale janë kryer nga shërbimet hidrogjeologjike e gjeofizike të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar dhe të Qendrës Kombëtare Shkencore të Kërkimeve të Hidrokarbureve [Avgustinskij V.L. etj., 1957, Avxhiu R. Etj. 1999, Dakoli H. etj. 1981, 2000, Dhima K. etj. 2000, Harta Hidrogjeologjike e Shqipërisë në shkallë 1: 200 000 , 1985, Eftimi R. etj., 1989, Reçi H. etj., 2001, Tartari M. etj., 1999, Velaj T. 1995].

Në vitin 2003, nga një ekip i gjerë i Shoqatës së Ruajtjes dhe Mbrojtjes së Ujërave Bregdetare dhe të Ëmbla të Shqipërisë, u realizua Projekti sensibilizues "Përdorimi i energjisë gjeoteormale miqësore me mjedisin në Shqipëri", UNDP-GEF, SGP. Ky Projekt u realizua së bashku me Institutin e Informatikës dhe të Matematikës së Aplikuar (INIMA).

Në kuadrin e këtij projekti u botua një broshurë, u përgatit një videokasetë mbi energjinë gjeotermale të Shqipërisë, u hatuan tre projekte ide mbi përdorimin e nxehtësisë së Tokës për ngrohjen e banesave dhe të serave, mbi përdorimin kompleks dhe kaskadë të energjisë së ujërave termale [Frashëri A etj., 2003], si edhe u organizuan katër workshope sensibilizuese. Broshura është përfshirë edhe në një faqe të internetit të INIMA, si bashkautore e projektit, me adresë:

http://www.inima.al/~nfra/geothermal

Me kërkesën e Institucionit Gjerman Geothermische-Vereinigung, kjo broshurë është futur edhe në faqen e tyre të Internetit: EGEC's GEOTHERNET:

http://www.Geothermie.de

Në kuadrin e këtij projekti u përgatit edhe drafti shqiptar i "Ligji i Energjisë Gjeotermale" [Frashëri E., 2003].

Periodikisht, rezultatet e studimeve gjeotermale kanë gjetur vlerësim pozitiv në artikujt e botuar, si edhe janë të referuar në simpoziume, workshope dhe në kongrese shkencore në Shqipëri dhe ndërkombëtare [Çermak V. etj., 1994, 1999, Frashëri A. 1991, 1992, 1993, 1993, 1993, 1993, 1994, 1995, 1996, 1997, 1998, 2001, Frashëri A. et al., 1995, 1996, 1996, 2002, 2003].

2. TË DHËNAT BAZË FIZIKO-GJEOLOGJIKE TË STUDIMIT GJEOTERMAL TË ALBANIDEVE

2.1. Vështrim mbi gjeologjinë e Albanideve

Albanidet përfaqësojnë strukturat gjeologjike që shtrihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Ato shtrihen midis Dinarideve dhe Helenideve dhe së bashku formojnë harkun Dinarid-Albanid-Helenid të rrudhosjes së brezit alpin mesdhetar (Fig. 1) [Aubouen I. dhe Ndoja I., 1964, Biçoku T. dhe Papa A. 1981, 1965, Bushati S. 1998, Frashëri A. etj., 1993, 1996, Harta Gjeologjike e Shqipërisë 1984, Harta Tektonike e Shqipërisë 1985, Meço S. dhe Aliaj Sh, 2000, Melo V., 1986, Papa A, 1993, Prenjasi E, 1999, Ricou E.L. et al., 1998].

Albanidet filluan zhvillimin e tyre qysh në triasik, mbi një nënshtrat hercinik dhe u formuan nga orogjeneza alpine. Në tektonogjenezat kryesore veçohen, ato: paleotektonike (jurasike dhe jurasiko-kretake), tektonike (kretake e vonshme dhe paleogjenike), tarditektonike (oligocenike dhe miocenike) dhe neotektonike (pliocenike-pleistocenike).

Në Shqipëri përhapen shkëmbinjtë e moshës më të vjetër ordovikiane e deri tek ata më të rinj, Antropogjenë. Albanidet i karakterizojnë dy treva paleogjeografike të mëdha, Albanidet e jashtme dhe Albanidet e brendshme. Albanidet e brendshme janë prekur vetëm nga etapa paleotektonike e tektonike, që solli daljen e ofioliteve, si ashkla të kores oqeanike, gjatë zhytjes së Adrias, pjesës së pllakës afrikane nën atë euroaziatike. Albanidet e jashtme janë prekur vetëm nga etapat e mëvonshme tektonike, tarditektonike dhe neotektonike. Fazat orogjenike kanë mërguar në hapësirë dhe në kohë, nga Albanidet e brendshme në lindje drejt perëndimit, Albanideve të jashtme.

Albanidet e brendshme karakterizohen nga prania e brezit ofiolitik madhor dhe të tektonizuar intensivisht, i cili vendoset si napë nga lindja në perëndim. Ka dy pikëpamje mbi vendosjen e ofioliteve: karakteri allokton i napës ofiolitike [Aubouin I. 1973, Cadet J.P. etj., 1980, Frashëri A. 2000, Hoxha L. 2000, Langora Ll. etj., 1983, Qirinxhi A. 1970] dhe vendosje aloktone relative me gjenezë në zonën e Mirditës. [Beçaluva L. etl. 1994, Bushati S. 1988, Gjata K. dhe Kodra A., 2000, Kodra A. 1993, 1998, Shallo M. etj., 1989]. Albanidet e jashtme janë zhvilluar anash skajit pasiv të pllakës adriatike [Aliaj Sh. 1987, Bare V. etj., 1996, Dalipi H. 1985, Frashëri A. etj., 1996, Mëhillka L. etj., 1999, Prenjasi E. 1999, Xhaçka P. etj., 1985, Xhufi C. dhe Canaj B., 1999].

2.1.1. Konfiguracioni i Kores së Tokës në Albanidet

Studimet sizmologjike dhe vrojtimet krahinore gravimetrike e magnetometrike kanë dhënë informacion për koren e Tokës në Albanidet [Arapi S., 1982, Bushati S. 1982, 1997, 1998, Frashëri A. etj., 1996, Koçiu S., 1989, Lubonja L. etj., 1968, Sulstarova E., 1987, Veizaj V. dhe Frashëri A. 1996]. Struktura e Kores së Tokës, sipas të dhënave të vrojtimeve sizmologjike të valëve të thyera, fillon të bëhet më e trashë, duke filluar nga rajonet qendrore të detit Adriatik drejt steresë së Albanideve (Fleta 1-a) [Koçiu S., 1989]. Korja sedimentare ka trashësi rreth 10 km në hapësirat e Adriatikut dhe rritet deri në 15 km në bregdetin e Shqipërisë (Fleta 1-a), [Frashëri A., etj. 1996, Koçiu S. 1986, Veizaj V. dhe Frashëri A. 1996]. Shkëmbinj që kanë shpejtësi të valëve sizmike 5.9- 6.2-km/sek përfaqësojnë shtresën e poshtme të kores sedimentare. Këta shkëmbinj kanë strukturë shumë kompakte. Në Albanidet janë fiksuar katër anomali Buge krahinore të forcës së gravitacionit [Bushati S. 1988]: dy maksimume dhe dy minimume (Fleta 2). Maksimumi gravitativ kryesor shtrihet mbi skajin veri-lindor të brezit ofiolitik. Maksimumi i dytë ndodhet në rajonin e Vlorës, i cili shtrihet pothuajse tërthor me shtrirjen e strukturave të Albanideve të jashtme. Këto maksimume gravitative lidhen me rritjen e trashësisë së kores në brezin ofiolitik si dhe në rajonin e Vlorës (Fleta 2, 4-a). Minimumi gravitativ kryesor shtrihet nga juglindja e Shqipërisë drejt bregdetit, në veri-perëndim të saj. Minimumi i dytë ndodhet në zonën e Alpeve Shqiptare [Dragashevic D. 1983, Bushati S. 1988]. Kufiri MOHO zhytet nga 25 km në Adriatikun qendror, në (43-45)km në pjesën lindore të Albanideve [Morelli C. etj., 1969, Finetti I. dhe Morreli C. 1972, Frashëri A. etj., 1993, 1996, Richetti G. 1980].

Në hapësirën e shelfit shqiptar të detit Adriatik drejt lindjes së Albanideve vërehet zmadhim i amplitudës së anomalisë Buge (Fleta 4-a). Në profilin gjeologo-gjeofizik Albanid-1 paraqitet zvogëlimi i thellësisë së kufirit MOHO në hapësirat e detit Adriatik (Fleta 4-a). Anomalitë krahinore të gravitacionit janë shkaktuar nga ndërtimi bllokor i kores, çka përputhet edhe me rezultatet e studimeve sizmologjike. Ndërtimi tektonik i niveleve të poshtme të kores së Tokës në Albanidet reflektohet edhe në përhapjen e fushës magnetike (Fleta 3). Sipas interpretimit të anomalive magnetike krahinore rezulton se tavani i bazamentit kristalin zhytet drejt litoralit shqiptar (Fleta 4-a).

Albanidet janë breza të rrudhosur tipike alpine që shtrihen në drejtim JJL-VVP. Strukturat e tyre janë asimetrike, me anim tektonik nga perëndimi, por takohen edhe struktura të shtrira e të përmbysura dhe të komplikuara me shkëputje në krahët perëndimorë, si rezultat i mbulesave tektonike të një zone mbi tjetrën, d.m.th. si pasojë e alloktonisë së plotë të Albanideve të brendshme, si edhe mbihipje e branisje të mëdha drejt perëndimit të disa strukturave antiklinale të Albanideve të jashtme; të shkaktuar nga kolizioni midis pllakës së Adrias e asaj Euroaziatike.

Albanidet ndërpriten nga thyerje të thella gjatësore; nga disa prej të cilave kanë shpërthyer evaporite. Krahas tyre, evidentohen edhe thyerje tërthore si ajo Shkodër-Pejë, Vlorë-Elbasan-Dibër etj. Këto thyerje përshkojnë të gjithë koren e Tokës dhe janë sizmogjene. Me thyerjet e thella lidhen edhe burimet e energjisë gjeotermale të Shqipërisë.

Ndërtimi tektonik i niveleve të thella të kores së Tokës dhe dinamika e saj, gjejnë pasqyrim edhe në strukturat gjeologjike të Albanideve dhe në stilin e tyre tektonik.

Studimet gjeologjike dhe gjeofizike krahinore kanë veçuar disa zona tektonike (Fleta 1-b):

Albanidet e brendshme: Zonat tektonike Korabi, Mirdita, Gashi,

Albanidet e jashtme: Zonat tektonike Alpet Shqiptare, Krasta-Cukali, Kruja, Jonike, Sazani dhe Ultësira Pranadriatike.

2.1.2. Albanidet e brendshme

2.1.2.1 Zona Korabi (Ko), e cila vazhdon tej kufijve të Shqipërisë me zonën Pelagoniane. Në këtë zonë dalin në sipërfaqe formacionet me moshë më të vjetër në vend, të cilat përfaqësohen nga rreshpe, ranorë, konglomeratë dhe gëlqerorë të metamorfizuar të silurianit - devonianit, shkëmbinj me pamje flishore të karboniferit, ranorë e konglomeratë të permianit-triasikut të poshtëm. Gjipset dhe anhidritet e rajonit të Peshkopisë janë të moshës triasike [Muhameti P. dhe Pajo I.].

Nga disa studiues pranohen si të zonës së Korabit, ndërsa nga studiues të tjerë interpretohen si dritare tektonike e zonave Albanideve të jashtme në thellësi të Albanideve të brendshme [Melo V.

1986, Velaj T. 2002]. Vende-vende takohen trupa të vegjël shkëmbinjsh vullkanikë e subvullkanikë, me përbërje bazike dhe acido-alkalinore. Shkëmbinjtë më të rinj janë gëlqerorët triasikë e jurasikë, flishet jurasiko-kretakë dhe eocen i sipërm-oligocen i poshtëm, si edhe molasat neogjenike. Zona e Korabit ka strukturë të ndërlikuar, me rrudha, shkëputje dhe mbulesa tektonike.

2.1.2.2. Zona Mirdita (M), e cila tej kufijve vazhdon me zonën Subpelagoniane në Greqi. Kjo zonë shtrihet si brez i gjerë gjatë gjithë territorit te vendit nga veriu në jug. Tre kate strukturore u formuan gjatë etapave të ndryshme orogjenike në zonën Mirdita. Kati i poshtëm përbëhet nga ofiolitet dhe formacionet kontinentale në periferi të tyre. Ofiolitet përfaqësojnë ashkla të kores oqeanike. Brezi ofiolitik jurasik rrethohet nga një bordurë e formacionit vullkano-sedimentar dhe gëlqerorë pelagjikë të moshës së triasikut të sipërm-jurasikut të mesëm. Mbi këta vazhdon melanzhi tektonik i jurasikut të sipërm-kretakut të poshtëm (flishi i hershëm) me olistrostrome të shumta gëlqerorësh neritikë [Prenjas E. etj., 1982].

Brezi ofiolitik përbëhet nga masivë ultrabazikë në të dy pjesët anësore dhe nga gabro, plagjiogranite-diorite kuarcore dhe vullkanogjenë në pjesën qendrore.

Ofiolitet janë formuar në trevën oqeanike të Tetisit dhe kanë dalë e kanë filluar të zënë vend nga fundi i jurasikut, duke u zhvendosur gradualisht drejt perëndimit mbi formacionet e buzinës kontinentale. Mbi ofiolitet vende-vende shtrihen gëlqerorë të kretakut që përbëjnë katin e dytë strukturor.

Gjatë etapave tardi-tektonike, veçanërisht neotektonike, në zonën Mirdita u formuan gropat molasike të brendshme, të tre gjeneracioneve: më të vjetra të oligocen-miocen i poshtëm, të tortonianit dhe të pliocenit. Depozitimet e molasave pas-orogjenike kanë mbuluar transgresivisht pjesë të zonës Mirdita dhe pjesërisht të zonës së Krasta-Cukali në basenet e Korçës dhe të Burrelit.

Anomali Buge intensive dhe fushë magnetike e turbullt karakterizojnë brezin ofiolitik (Fleta 2, 3) [Bushati S. 1997, 1998, Frashëri A. etj. 1996]. Brezi ofiolitik ka trashësi deri në 14 km në masivin ultrabazik të Kukësit. Drejt perëndimit dhe juglindjes së vendit, kjo trashësi reduktohet deri në 2 km (Fleta 4-a, 4-b). Ky interpretim vërteton karakterin allokton të ofioliteve dhe atë mbulesor të kontaktit perëndimor të zonës Mirdita mbi formacionet e zonës Krasta-Cukali. Ndarja e anomalive të gravitacionit dhe magnetike në rajonet qendrore të Albanideve të brendshme, në korridorin flishor të Shëngjergjit vërtetojnë gjithashtu karakterin mbulesor të ofioliteve dhe praninë e tërthores Dibër-Elbasan-Vlorë (Fleta 2, 3).

2.1.1.3. Zona e Gashit (G), e cila tej kufijve, në veri, vazhdon me zonën e Durmitorit në Dinaridet. Në këtë zonë përhapen shkëmbinjtë terrigjenë dhe gëlqerorë pak të metamorfizuar të silurian-devonianit, si edhe shkëmbinjtë vullkanogjenë të metamorfizuar me përbërje bazike, mesatare acide dhe rrallë shkëmbinjtë pikritikë. Shkëmbinjtë terrigjenë e vullkanikë i ndan masivi granodiorit i Trokusit.

2.1.3. Albanidet e jashtme

2.1.3.1. Zona e Alpeve (A), e cila vazhdon me zonën e Karstit të Lartë në Dinaridet. Ranorët dhe konglomeratët e moshës permiane, janë shkëmbinjtë më të vjetër të kësaj zone. Mbi këta shtrihen shkëmbinj karbonatikë me ndërshtresa të tufeve vullkanike të triasikut të mesëm, gëlqerorë e dolomite të triasikut të sipërm dhe gëlqerorë neritikë organogjenë të jurasikut-kretakut, me disa ndërshtresa stralli, si edhe flishe të majës të kretakut të poshtëm-eocenit. Kjo zonë i është nënshtruar fillimisht tektonogjenezës së eocenit të vonë. Strukturat e Alpeve përfaqësohen nga monoklinale të kombinuar me antiklinale të vogla.

2.1.3.2. Zona Krasta-Cukali (KC), vazhdon tej kufijve shtetërorë shqiptarë me zonën e Pindit në Helenidet dhe të Budvës në Dinaridet. Kjo është një zonë ndërmjetëse midis Albanideve të brendshme dhe Albanideve të jashtme. Zona Krasta-Cukali është nënshtruar fillimisht tektonogjenezës së eocenit të vonë. Kjo zonë ndahet në dy nënzona:

Nënzona Cukali, e cila shtrihet në pjesën veriore, midis Alpeve Shqiptare dhe zonës Mirdita. Ajo ndërtohet nga shkëmbinj karbonatikë të mesozoit (nga triasiku deri në kretak), disa shkëmbinj vullkanogjenë të trisikut të mesëm dhe pak radiolarite në tavanin e jurasikut të sipërm. Mbi këta shkëmbinj vendoset flishi i paleocenit-eocenit. Këta shkëmbinj formojnë një antiklinal të madh, me disa rrudha të vogla në sfondin e tij. Zona e Alpeve Shqiptare dhe ajo e Mirditës janë të mbihedhur mbi nënzonën e Cukalit.

Nënzona Krasta, e cila shtrihet si një brez i ngushtë nga Shkodra në veri deri në skajin juglindor të Shqipërisë, në Leskovik. Në këtë brez përhapen tre formacione: flishi i albian-cenomanianit, seria e gëlqerorëve të senonianit dhe flishi i maastriktian-eocenit. Flishi i nënzonës Krasta shfaqet edhe në korridorin e Shëngjergjit, duke ndarë brezin ofiolitik në dy pjesë. Kjo zonë mbihipën drejt perëndimit në formë nape mbi zonën Kruja.

2.1.3.3. Zona Kruja (Kr), e cila tej kufijve vijon me zonën Dalmate në Dinaridet dhe në jug me atë të Gavrovës në Helenidet.

Në pjesën e poshtme të prerjes së zhveshur të saj shtrihen shkëmbinj karbonatikë neritiko-pelagjikë të kretak-paleogjenit dhe mbi ta vendoset flishi oligocenik, i cili ka trashësi deri në 5km. Rrudhosja kryesore e kësaj zone u bë në oligocenin e mesëm dhe në miocenin e poshtëm e të mesëm, prandaj, vende-vende takohen edhe vendosje transgresive të depozitimeve të oligocenit të sipërm dhe sidomos të miocenit mbi ato më të vjetrat [Nishani P. 1985]. Në zonën e Krujës ekziston pushimi stratigrafik në nivelin e paleocen-eocenit, diapazoni i të cilit lëviz nga një varg antiklinal në tjetrin. Kjo zonë ndërtohet nga disa vargje antiklinale dhe sinklinale, me vendosje shkallore ulëse drejt perëndimit. Këto struktura janë lineare dhe kanë gjatësi disa dhjetëra kilometra. Antiklinalet, në përgjithësi kanë krah perëndimor të këputur nga tektonika mbihipëse, prandaj ato shpeshherë vrojtohen vetëm si monoklinale me rënie lindore, siç është ai i vargut Dajti-Krujë. Përgjatë mbihipjeve, gëlqerorët dhe dolomitet e kretakut kontaktojnë tektonikisht me flishet oligocenikë të sinklinaleve në perëndim.

2.1.3.4. Zona Jonike (J), e cila vazhdon me të njëjtin emër, tej kufijve në Helenidet. Kjo është zona më e madhe e Albanideve të jashtme dhe është zhvilluar si hulli e thellë pelagjike, qysh nga liasiku i sipërm.

Evaporitet e triasikut të sipërm janë shkëmbinjtë më të vjetër të kësaj zone. Mbi ta shtrihet formacioni i trashë i gelqerorëve neritikë dhe dolomiteve të triasikut të sipërm-jurasikut të poshtëm, gëlqerorët pelagjikë me ndërshtresa stralli të jurasikut-kretakut-paleogjenit. Gëlqerorët vijojnë me flishin oligocenik, dhe me formacionin flishoidal të akuitanianit. Shliret e burdigalianit-langhinianit dhe pjesërisht të serravalian-tortonianit mbushin kryesisht brezat sinklinalë.

Veprimet e tektogjenezës, që janë shfaqur një pas një në zonën Jonike, kanë shkaktuar rrudhosjen e strukturave. Rrudhosjet kryesore janë ato të miocenit të poshtëm dhe të mesëm.

Janë formuar tre breza antiklinalë, të cilët janë të ndarë nga breza sinklinalë:

a) **Brezi antiklinal i Beratit**, në anën lindore të zonës.

b) **Brezi antiklinal i Kurveleshit**, në pjesën qendrore të zonës.

c) **Brezi antiklinal i Çikës**, që përfaqëson anën perëndimor të zonës Jonike.

Këta breza, në përgjithësi, kufizohen midis tyre me mbihipje tektonike krahinore. Brezat antiklinale janë të përbërë nga vargje antiklinale, me bërthama gëlqerore. Vargje sinklinale ndajnë antiklinalet njëri nga tjetri. Strukturat janë me asimetri perëndimore dhe kanë shtrirje të përgjithshme juglindje-veriperëndim. Ato kanë amplitudë disa kilometra. Drejt perëndimit strukturat bëhen më asimetrike dhe rrafshet aksialë bien drejt verilindjes. Në të shumtat e rasteve, krahët perëndimorë të antiklinaleve janë ndërprerë nga tektonika shkëputëse, deri në mbihipëse me amplitudë 5-10 km [Prenjasi E., 1992]. Shkëputjet mbihipëse regjionale si ajo midis zonës Jonike dhe plaatformës Pre-Apuliane (Sazani) kanë amplitudë disa kilometra dhe depërtojnë në thellësi të mëdha, duke prekur të gjithë Koren e Tokës. Në to vendosen vatra tërmetesh. Tektonikat mbihipëse të kundërta janë shkaktuar nga dukuritë tektonike zbrapëse.

Dy stile tektonike janë dalluar në zonën Jonike: stili i tektonikës së dyfishtë dhe ai tjegullor. Gjeodinamika e zonës Jonike është lidhur me evolucionin e prishjeve tektonike tërthore. Këto prishje e kanë ndarë basenin jonian në disa blloqe, qysh nga koha e riftimit në jurasikun e poshtëm dhe të mesëm. Riaktivizimi periodik i prishjeve tërthore kanë luajtur gjithashtu, një rol të rëndësishëm në dukurinë e mbihipjes. Në profilin krahinor sizmik, që kalon nëpër zonën Jonike, duket qartë se gjatë procesit të strukturimit të zonës Jonike, nga oligoceni i sipërm deri në langhian, kanë ndikuar gëlqerorët e nënshtruar të basenit të Adriatikut dhe të zonës së Sazanit (Fleta 5).

Karakteristikë e përbashkët e brezave strukturorë të zonës Jonike dhe Kruja janë ndërlikimet tektonike dhe mbihipja e tyre perëndimore [Aliaj Sh. 1987, Bare V. etj., 1996, Mëhillka Ll. etj., 1999, Prenjasi E., 1999, Xhufi C. dhe Canaj B, 1999]. Procesi i mbihipjes ndihmohet edhe nga prania e trashësisë evaporitike triasike nën prerjen karbonatike.

Si rrjedhojë e lëvizjeve tektonike të njëpasnjëshme, depozitimet e Miocenit të poshtëm, të mesëm e të sipërm janë të vendosur me diskordancë mbi brezat antiklinalë dhe ata kalimtarë për në brezat sinklinalë. Këta të fundit janë rrudhosur në tortonian-pliocen. Kjo dukuri ka çuar në ndërtim dykatësor (Fleta 5). Strukturat zhyten drejt veriut, ku mbulohen nga molasa e Ultësirës Pranadriatike.

2.1.3.5. Zona Sazani (S), është vazhdim i platformës Apuliane. Ajo ndërtohet nga një prerje e trashë gëlqerorësh e dolomitesh kretako-oligocenike. Transgresisht mbi formacionin karbonatik, vendosen depozitimet mergelore të burdigalianit.

2.1.3.6. Ultësira Pranadriatike (UPA), është ultësirë paramalore e mbushur me molasa miocenike dhe pliocenike, të cilat përgjithësisht janë të mbuluara nga depozitimet kuaternare (Fleta 5). Depozitimet e saj janë vendosur mbi pjesën veri-perëndimore të zonës Jonike dhe pjesërisht mbi zonat Kruja dhe Sazani. Ultësira Pranadriatike filloi të zhvillohet në fazën tektogjene të seravalian-mesinianit, e cila kish filluar në oligocen dhe shkaktoi rrudhosjen e zonave Kruja, Jonike dhe Sazani. Trashësia e molasave zmadhohet nga juglindja në veriperëndim, duke arritur në 5000m.

Depozitimet ranorike-argjilore të serravalianit, të tortonianit dhe mesinianit vendosen trasgresivisht mbi depozitimet më të vjetra, deri te gëlqerorët, duke krijuar një ndërtim strukturor dykatësor. Depozitimet e pliocenit janë argjilore dhe ranoro-konglomeratike.

Në periferinë lindore të saj, depozitimet e Ultësirës vendosen transgresivisht mbi vargjet antiklinale dhe sinklinale të zonës Jonike dhe Kruja, duke filluar që mbi shliret dhe flishin deri te gëlqerorët.

Molasa e Ultësirës është e rrudhosur dhe formon disa antiklinale, brahiantiklinale dhe sinklinale. Në verilindje shtrihet sinklinali i Tiranës. Ai ka krah lindor relativisht të qetë, ndërsa krahu perëndimor ka rënie shumë të madhe deri i përmbysur. Ky krah, në veri të sinklinalit komplikohet me shkëputje tektonike. Mjaft i gjerë është edhe sinklinali i Myzeqesë. Në perëndim të tij shtrihet vargu i antiklinaleve Ardenicë-Divjakë-Kryevidh-Durrës.

Baseni sedimentar shqiptar vazhdon dhe në shelfin shqiptar të detit Adriatik, si me formacionin terrigjen ashtu edhe atë karbonatik.

Zonat tektonike të Albanideve të jashtme ndodhen në regjim tektonik shtypës qysh nga periudha e jurasikut të sipërm-kretakut [Aliaj Sh., 1987, Meço S. dhe Aliaj Sh, 2000, Sulstarova E., 1987]. Vetëm në pjesën perëndimore, zona Apuliane dhe baseni i Adriatikut jugor ndodhen në regjim tektonik të vazhdueshëm në tërheqje.

Tektonika mbihipëse e kundërt në zonën Jonike dhe Sazani është dukuri neotektonike. Modelet e formuara strukturore-tektonike paraqiten, si rezultat i interferencës të dy efekteve, të mbihipjes jugperëndimore dhe efektit të mbihipjes dytësore të re veriperëndimore. Gjatë ciklit molasik, strukturat dhe vargjet strukturore të zonave Kruja, Jonike dhe Sazani kanë zmadhuar shkallën e mbihipjes dhe të mbihipjes së kundërt, si rezultat i zhvillimeve tektonike të fuqishme. Kjo dukuri shpeshherë luan rol kryesor në formimin e blloqeve tektonikë me natyre tjegullore.

2.2. Modelet gjeotermale të Albanideve

Studimet gjeotermale, të klasifikuara sipas parametrave të temperaturës në nivele thellësiore të ndryshme, si edhe të gradientit gjeotermal, krahas njohjes së përhapjes së fushës termale të Tokës, si objektiv përfundimtar kanë patur edhe vlerësimin e dendësisë së fluksit të nxehtësisë.

Njohja e fluksit të nxehtësisë krijon mundësitë për të vlerësuar:

- Nxehtësinë dhe shkallën e maturimit të lëndës organike gjatë llogaritjeve gjeologo-gjeokimike të rezervave të naftës dhe të gazit në fazat prognozë dhe në ato më të detajuara të kërkimit të vendburimeve të naftës dhe të gazit.
- Burimet e energjisë gjeotermale ekzistuese dhe të kërkimin e burimeve të reja.
- Gjendjen termale të masivëve shkëmbore në fushat e minierave të thella, për zgjidhjen e problemeve të ndryshme teknike, në radhë të parë të ajrimit të minierave.
- Paleoklimën dhe ekstrapolimin e të dhënave të parashikimeve, në kuadrin problemeve të mjedisit.

Nisur nga kjo rëndësi, vlerësimi i fluksit të nxehtësisë është bërë me të dhënat më të sigurta të temperaturës, të regjistruara në kushte të qëndrueshmërisë termike të puseve dhe me termograma të padeformuara nga procese gjeomorfologjike, litologo-strukturore dhe hidrodinamike sipërfaqësore dhe të thellësisë. Për këto arsye është analizuar me imtësi ndikimi i përbërjes litologjike dhe strukturore, si edhe dukuritë e hidrodinamikës në madhësinë e gradientit gjeotermal.

Vlerësimi i dendësisë së fluksit të nxehtësisë bëhet duke klasifikuar puset sipas modeleve gjeotermale, në pajtim me kriterin që madhësia e dendësisë së fluksit të përcaktohet për pjesën relativisht më homogjene të prerjes gjeologjike të shpuar nga puset:

1. ***Modeli i suites argjilore Helmësi të pliocenit***, për Ultësirën Pranadriatike.
2. ***Modeli i prerjes molasike të serravalian - tortonianit***, për rajonet Durrës, Tiranë, Kuçovë e Memaliaj.
3. ***Modeli i prerjes mergelore të burdigalianit***, për rajonin e Vlorës.

4. ***Modeli i prerjes flishore të oligocenit***, për rajonet Ballsh-Cakran-Gorisht-Kocul, Kreshpan, Lanabregas, Prishtë, Sasaj dhe Vurg.
5. ***Modeli i prerjeve halogjene***, në diapiret e Xarës dhe të Dumresë, ku bëjnë pjesë pusi i Butrintit dhe puset e Dumresë.
6. ***Modeli i prerjes ultrabazike*** për rajonet e masivit ultrabazik të Bulqizes, të Kukësit, dhe të Tropojës.
7. ***Modeli i prerjes së shkëmbinjve vullkanogjenë*** të pakove të poshtme dhe të sipërme, për rajonet e Mirditës dhe Rehovës në Korçë.
8. ***Modeli i prerjes karbonatike*** në Alpet Shqiptare.

Për rritjen e saktësisë së modelimit në pjesën e prerjes gjeologjike të studiuar u vlerësuan vetitë termike të ponderuara në varësi të litologjisë faktike të prerjes. Deshifrimi litologjik u bë në diagramat e karrotazhit, sipas rezistencës së dukshme dhe të polarizimit spontan.

2.3. Vetitë termike të shkëmbinjve

Vetitë termike janë studiuar për një diapazon të gjerë dhe për lloje të ndryshme shkëmbinjsh, që ndërtojnë prerjet e puseve, ku u llogarit dendësia e fluksit termik [Hanel R. etj., 1996, Mongelli 1981, Mongelli F. dhe Zito G. 1993]. Mostrat janë marrë në puset ose në zhveshje natyrore për moshat dhe llojet litologjike të ndryshme. Në pasqyrën 1 (faqe 82) jepen rezultatet e përcaktimeve të përcjellshmërise termike, të kapacitetit termik dhe të difuzionit termik. Këto rezultate janë shfrytëzuar për të llogaritur dendësinë e fluksit të nxehtësisë. Analiza e përcjellshmërisë termike, e cila është parametër që nevojitet për të llogaritur dendësinë e fluksit të nxehtësisë, për lehtësi shtjellimi në këtë tekst, është bërë duke analizuar rezultatet e përgjithësimit të të dhënave petrotermike, të cilat paraqiten në pasqyrën 2 (faqe 82).

Nga të dhënat e kësaj pasqyre, duket se ranorët e tortonianit dhe të oligocenit, po kështu edhe argjilat e tortonianit kanë vlerën më të madhe të përcjellshmërisë termike, duke arritur përkatësisht deri në 5.707 dhe 5.034 $W.K^{-1}.m^{-1}$. Vlera të larta të përcjellshmerisë termike janë fiksuar edhe te shkëmbinjtë magmatikë, veçanërisht tek ultrabazikët, të cilët kanë përcjellshmërinë termike deri në 3.828 $W.K^{-1}.m^{-1}$. Shmangia mesatare kuadratike arrin vlera absolute të rendit nga 0.101 deri në 1.218 $W.K^{-1}.m^{-1}$, vlera relative e të cilit arrin në 5.6 deri në 38.6%, ose mesatarisht 14.5 %. Këto shpërndarje të vlerave të përcjellshmërisë termike janë patur parasysh në vlerësimin e ndikimit të tyre gjatë llogaritjes së dendësisë së fluksit termal.

Vlerësimi i analizave për përcjellshmërinë termike në drejtim vertikal është bërë në dy rrugë:

a) Duke kryer matje të përcjellshmërisë në mostra të marrë në të njejtin pus të thellë të naftës e të gazit (Pasqyra 2). Nga sa duket nga prerja gjeotermale e paraqitur në këtë pasqyrë, përcjellshmëria termike luhatet nga 1.040 deri në 2.900$W.K^{-1}.m^{-1}$ për një prerje të molasave neogenike, me trashësi 5100m. Flishi oligocenit të poshtëm ka përcjellshmëri termike që luhatet nga 2.097 deri në 3.573$W.k^{-1}.m^{-1}$.

b) Duke llogaritur dendësinë e fluksit të nxehtësisë, sipas inversionit për prerjen gjeotermale të pusit Kolonja-10, nisur nga prerja argjilore e suites Helmesi të pliocenit, me përcjellshmëri termike të njohur. Sipas madhësisë së këtij fluksi, duke patur të njohur gradientin gjeotermal, është vlerësuar përcjellshmëria termike e prerjes së suitave të ndryshme. Në pasqyrën 3 (faqe 83) jepen rezultatet e inversionit dhe krahasimi i vlerave të gjetura nga inversioni me mesataret e matura. Siç duket, përputhja është e mirë dhe ndryshimi është më i vogël se sa gabimi i matjes.

3. METODIKA E VROJTIMIT, E PERPUNIMIT DHE INTERPRETIMIT TË REZULTATEVE TË STUDIMEVE GJEOTERMALE

Studimet gjeotermale në Shqipëri, janë orientuar në disa drejtime:

1. Matja e temperaturës në puse dhe në miniera të thella. Temperatura është regjistruar në 120 puse të thellë nafte e gazi të vendosur në pjesën jugperëndimore të Shqipërisë dhe në 25 puse të cekët në rajonet lindore të vendit, të ndodhur në nivele hipsometrike të ndryshme. Në puset e thellë temperatura është regjistruar në mënyrë të vazhdueshme. Matja e temperaturës në puset e cekët dhe matjet e kontrollit të temperaturës në puset e thellë janë kryer me hap (5–10)m. Temperatura është matur me termometra elektrikë me rezistencë dhe me termistor. Gabimi mesatar absolut i matjes është 0.3°C. Në përgjithësi, regjistrimi i temperaturës është bërë në puse me regjim termik të vendosur dhe të mbushur me solucion argjile ose me ujë, gjatë uljes të termometrit në pus. Gabimi mesatar kuadratik i matjeve të kontrollit ka rezultuar ±0.14°C, çka tregon për saktësinë e lartë të matjes.

Në disa raste, kur nuk ka qenë e mundur të regjistrohej temperatura në regjim termik të vendosur, gjatë procesit të shpimit, u përdor metoda e Drury (Drury, 1984) dhe nomograma e Horner-it, për llogaritjen e gradientit gjeotermal. Matjet e temperaturës me termometra elektrikë u kontrolluan në disa puse edhe me matje me termometër maksimal me zhivë në thellësi. Ka patur përputhje të mirë midis dy mënyrave të matjes: shmangia standarde mesatare kuadratike ishte 1.6°C dhe gabimi mesatar relativ, më i vogël se 5%. Të dhënat e dy-tre puseve, ku gabimi mesatar relativ ka qenë më i madh se 5%, nuk janë marrë parasysh për llogaritjen e dendësisë së fluksit termal.

Të dhënat e regjistruara u përpunuan me analizën e trendit të rendit të parë dhe të dytë.

Termogramat e të gjithë puseve të thellë e të cekët, që ndodheshin në zona me reliev të thyer janë korrigjuar për ndikimin e relievit:

$$G_1 = \sum_{1}^{12} \frac{(G - G_0)\cdot h_i \cdot \Delta r_i}{\left[1 + \left(\frac{z}{r_i}\right)^2\right]^{\frac{3}{2}} \cdot r_i} \quad , \text{[në °C/m]} \qquad \textbf{(1)}$$

ku: hi – lartësia relative lokale e unazës me rreze mesatare r_i dhe me gjerësi r_i, në m.

G, G_0-gradienti mesatar dhe në sipërfaqe i temperaturës në pus, në °C/m

Ga - gradienti mesatar i temperaturës së ajrit, i marrë [G_a=0.006 °C/m]

z - thellësia ku bëhet korigjimi

U vlerësua edhe deformimi lokal i gradientit në thellësinë Z:

$$G_2 = \sum_{1}^{12} \frac{\left[1 - 2\left(\frac{z}{r_i}\right)^2\right] \cdot (G - G_a) \cdot h_i \cdot \Delta r_i}{\left[1 + \left(\frac{z}{r_i}\right)^2\right]^{\frac{3}{2}} \cdot r_i^2} \quad \text{, [në °C/m]} \qquad \textbf{(2)}$$

Për pusin më karakteristik në Ultësirën Pranadriatike (Kolonja-10) është bërë edhe korrigjimi për sedimentimin deri në dyshemenë e moshës së serravalianit.

Me rezultatet e përpunimit shifror u ndërtuan hartat, duke përdorur programin Surfer. U ndërtuan hartat e temperaturës për thellësinë 100, 500, 1000, 2000 dhe 3000m dhe harta e gradientit gjeotermal mesatar. Për Albanidet e jashtme, ku ndodhen puset e naftës dhe të gazit, hartat janë ndërtuar në shkallën 1: 500000, kurse për të gjithë territorin Shqiptar në shkallën 1: 1000000, në pajtim me kërkesat teknike për dendësinë e pikave të vrojtimit.

Për Atlasin, hartat janë zvogëluar në shkallën 1: 1 500000, për ti përfshirë në formatin e Altasit të miratuar nga Projekti. Mbi bazën e modeleve gjeotermale dhe të modelimit matematikor është kryer edhe ekstrapolimi për vlerësimin e temperaturës në thellësitë e mëdha në zonat e Albanideve të brendshme, ku puset janë të cekët. Janë zgjedhur vetëm puse ku gradienti gjeotermal është i padeformuar nga faktorët e ndryshëm gjeologjikë e morfologjike, informacioni i të cilëve shërbeu edhe për llogaritjen e dendësisë së fluksit termal. Për këtë arsye janë ndërtuar dy lloj harta për këto thellësi të mëdha: Harta për të gjithë Shqipërinë dhe harta vetëm për territorin e Albanideve të jashtme ku ndodhen puset e thellë të naftës dhe të gazit dhe ku temperatura është matur deri në thellësitë (3000–4000)m. Këto vlera të temperaturës janë krahasuar edhe me temperaturat e ekstrapoluara, të dhëna në Atlasin Gjeotermal të Europës. Nga ky ballafaqim rezulton se temperaturat për të dyja rastet janë të afërta dhe kanë ndryshime të pranueshme.

2. Matja e vetive termale të shkëmbinjve. U përcaktuan 392 mostra, sipas modeleve gjeotermale të ndryshme. Përcaktimet janë kryer me metodën krahasuese të qëndrueshme, me aparaturat tip ISOMET Model 4 dhe “Shotherm” QTM-2, me anën e të cilave maten të gjitha vetitë termike të treguara më lart. Saktësia e matjes së mostrave ishte e lartë. Gabimi mesatar kuadratik i përcaktimit të përcjellshmërise termike është +/- 0.29 Wk-1m-1.

3. Llogaritja e dendësisë së fluksit të nxehtësisë, sipas modeleve gjeotermale të treguara në paragrafin 2.2, me formulën:

$$q = \lambda \cdot \frac{dt}{dh} \quad \text{, [në mW/m2]} \qquad \textbf{(3)}$$

ku: - përcjellshmëria termale e shkëmbinjve
- gradienti gjeotermal

Dendësia e fluksi të nxehtësisë për Ultësirën Pranadriatike u llogarit për prerjen e suitës pliocenike Helmësi, vetëm me termogramat me cilësinë më të lartë. Për këtë vlerësim është përcaktuar madhësia mesatare (1.94±0.07)$Wm^{-1}K^{-1}$ e përcjellshmërisë termike të argjilave të kësaj suite. Shmangia mesatare kuadratike është: ±0.078 $Wm^{-1}K^{-1}$. Gabimi i mundshëm në vlerësimin e madhësisë mesatare të tij është shumë i vogël, ±3.6%, për shkallën e sigurisë 95%, për numrin e mostrave të përcaktuar.

Shpërndarja faktike e vlerave të përcjellshmërisë termike të shkëmbinjve sjell luhatjen edhe të dendësisë së llogaritur të fluksit të nxehtësisë. Nga llogaritja rezulton se mesatarisht, dendësia e fluksit të nxehtësisë mund të luhatet deri në masën $10mW/m^2$, për prerjen flishore të oligocenit dhe $14mW/m^2$ për ofiolitet, në krahasim me vlerat e paraqitura në pasqyrën 5, me të cilat është ndërtuar harta. Ky vlerësim është bërë për masën e shmangies mesatare kuadratike të përcjellshmërisë termike të komplekseve të mësipërme të shkëmbinjve.

4. Studimi nga pikëpamja gjeologjike, hidrogjeologjike, kimike dhe gjeotermale e tetë burime të ujërave termale, një burim avulli gjeotermal dhe tetë puse gjeotermalë që ndodhen në Shqipëri.

5. Vlerësimi i éresurseve të energjisë gjeotermale dhe veçimi i zonave potenciale, në të cilat mund të shfrytëzohet energjia gjeotermale në Shqipëri. Për këto burime u llogaritën edhe rezervat e energjisë gjeotermale.

6. Përvijimi i rrugëve të shfrytëzimit kompleks dhe kaskadë të energjisë gjeotermale në Shqipëri.

Studimet gjeotermale janë shtrirë në të gjithë territorin shqiptar dhe në brezin ndërkufitar Shqipëri-Greqi dhe Shqipëri-Maqedoni.

Të dhënat e puseve në territorin e Republikës së Shqipërisë janë lidhur me të dhënat e dy puseve që ndodhen pranë kufirit Shqiptaro-Grek, njëri Greqi-8 në Jug te Butrintit, si edhe tjetri Napoli-2 në lindje të Malit të Gramozit, në dy puset e shpuara në Adriatik, njëri në veriperëndim të Durrësit dhe tjetri në veriperëndim të Vlorës. Kësisoj, hartat e temperaturave, të gradientit gjeotermal dhe të dendësisë së fluksit të nxehtësisë të Republikës së Shqipërisë janë të lidhura me ato të Greqisë dhe të Shelfit të Adriatikut.

Llogaritja e rezervave të fushave gjeotermale potenciale është bërë në pajtim me "Udhëzuesin e Rekomandimeve të Komisionit Ndërkombëtar të Fluksit Termal" të botuar në "Manual për përcaktimin e dendësisë së fluksit të nxehtësisë së Tokës", nga botuesi Haenel R., Rybach L.,Stegena 1996, si edhe Rach Golf van T.D. 1982, Doracaj M. 1986.

Nxehtësia në vend (Q_o), që ka një akuifer i dhënë, përcaktohet duke shfrytëzuar modelin vëllimor të nxjerrjes së nxehtësisë:

$$Q = (1-P)\cdot g_m \cdot c_m + P \cdot g_w \cdot c_w \cdot (T_t - T_0)\cdot A \cdot \Delta Z \qquad \textbf{(4)}$$

ku:

P - poroziteti efektiv
g - dendësia mesatare e shkëmbinjve ose e kolonës së ujit.
c - kapaciteti i nxehtësisë specifike të shkëmbinjve ose të ujit.
T_t - temperatura në tavanin e akuiferit
T_0 - temperatura në sipërfaqen e Tokës
A - sipërfaqja e zonës së studiuar
ΔZ - trashësia reale e akuiferit
m - indeksi për matriksi i shkëmbit
w - indeksi për ujë

Rezervat e identifikuara në grykën e pusit të vetmuar (Q_i), llogaritet me funksionin:

$$Q_i = Q_0 \cdot R_0 \qquad \textbf{(5)}$$

ku: Ro është faktor i rikuperimit, i ndryshëm për puset me dhe pa ri-injektim:

$$R_0 = 0.33 \cdot \frac{T_t - T_r}{T_t - T_0} \qquad \textbf{(6)}$$

ku: T_r- temperatura e ujit të ri - injektuar, °C

Rezervat e provuara në grykën e pusit (Q_2), u llogaritën me ekuacionin:

$$Q_2 = R_1 \cdot Q_1 \qquad \textbf{(7)}$$

Faktori i rikuperimit (R_1), përcaktohet nga madhësia e energjisë së nxjerrshme, kostos së instalimeve (I), dhe rezervave të identifikuara (Q_1):

$$R_1 = \frac{E - I}{Q_1} \qquad \textbf{(8)}$$

$$E = Q_v \cdot (T_t - T_r) \cdot g_w \cdot c_w \cdot \Delta t \qquad \textbf{(9)}$$

$$I = \frac{I_\$ \cdot C}{P_r} \qquad \textbf{(10)}$$

ku:

I – kosto e instalimeve të pusit të vetëm ose të sistemit me dy puse, e shprehur në nxehtësi,
I_s - kosto e instalimeve ku përfshihet kosto e shpimit dhe kompletimit të pusit,
C – përmbajtja e nxehtësisë specifike të naftës,
P_r – çmimi i naftës në kohën e dhënë,
Δt- afati i shërbimit të instalimit
Q_v – prurja e ujit nga akuifer i kufizuar

Duke konsideruar regjimin e qëndrueshëm të prurjes së ujit nga akuiferi, dhe faktin se ka vetëm luhatje shumë të vogla të prurjes dhe të presionit në grykën e pusit për një periudhë të gjatë kohe, (afërsisht 30 vjeçare) parametrat fizike, si përshkueshmëria (k), përçueshmëria hidraulike (k_f) dhe transmetueshmëria (T_v), u vlerësuan me ekuacionet:

$$Q_v = \frac{2\pi T_v S}{\ln\left(\frac{R}{r}\right)} \qquad \textbf{(11)}$$

dhe

(12)

dhe
$$Q_v = 2\pi rz \frac{\sqrt{K_1}}{15} \quad \textbf{(12)}$$

Për rastin e burimeve gjeotermale të zonës Kruja është supozuar karakteri homogjen anizotrop i kolektorit karbonatik me çarje lidhur me rrjedhjen e ujit.

Në këtë rast është përcaktuar tenzori i përshkueshmërisë, d.m.th. është përllogaritur përshkueshmëria e çarshmërisë sipas dy drejtimeve, si edhe dendësia e tyre lineare:

ϕ

$$k = \sum_{i=1}^{N} \frac{b_i^2 \cdot \phi_i}{12} \quad \textbf{(13)}$$

$$\phi = \sum_{i=1}^{N} b_i \cdot D_i \quad \textbf{(14)}$$

ku:
N - numri i sistemeve të çarjeve
b_i – gjerësia mesatare e sistemit të çarjeve
$_i$ – poroziteti i sistemit të çarjeve
D_i – dendësia lineare e sistemit

Është vlerësuar fuqia termale e mundshme për instalim (Lund J. W, 1996, Rybach L. et al. 2000):

$$\text{Fuqia termale} = \text{Prurja max.(kg/sek)} \times \left[\text{temper.hyrje}(^{O}C) - \text{temper.dalje}(^{O}C)\right] \times 0.004184 \text{ ne MWt}$$

energjia vjetore e përdorur:

$$\text{Energjia vjetore e perdorur} = \text{Prurja mes.(kg/sek)} \times \left[\text{temper.hyrje}(^{\circ}C) - \text{temper.dalje}(^{\circ}C)\right] \times 0.03154 \text{ ne TJ/vit}$$

si edhe faktori i kapacitetit termik:

$$\text{Faktori i kapacitetit termik} = \frac{\text{Energjia vjetore e perdorur(TJ/vit)}}{\text{Fuqia termike e instaluar (MWt)}} \times 0.03171$$

II. GJEOTERMIA E ALBANIDEVE

4. ENERGJIA GJEOTERMALE NË SHQIPËRI

Energjia gjeotermale është energji e rinovueshme, miqësore me mjedisin, që lidhet me:

· Fluksin e nxehtësisë së Tokës

· Ujërat e nxehtë që burojnë nga nëntoka ose fontanojnë nga puset.

4.1. Regjimi Gjeotermal i Albanideve

Gjendja gjeotermale e Albanideve kushtëzohet nga shpërndarja e fushës së temperaturave në thellësi të ndryshme, gradienti gjeotermal dhe dendësia e fluksit të nxehtësisë, në lidhje të ngushtë me litologjinë, me tektonikën dhe hidrodinamikën e ujërave nëntokësore.

4.1.1. Temperatura

Shpërndarja e fushës së temperaturës në Atlas është bërë për thellësitë (100, 500, 1000, 2000, dhe 3000)m (Fleta 7, 9, 10, 11, 12).

Sasia e nxehtësisë dhe temperatura në sipërfaqen e Tokës, si edhe ndryshimi i temperaturës me thellësinë në prerjen pranësipërfaqësore dhe brezin e temperaturës konstante i përcaktojmë nga pozicioni gjeografik, kushtet gjeomorfologjike, si pjerrësia e tokës dhe pozicioni i saj ndaj diellit, përbërja litologjike dhe nxehtësia specifike e mbulesës së shkrifët dhe e shkëmbinjve rrënjësorë nën ta, lagështia e tyre, si edhe stina e moti. Sipas studimeve hidrometeorologjike shumë vjeçare rezulton se gjatë stinës së verës, zonat fushore dhe jugperëndimore marrin mesatarisht 140,000 kalori.cm^{-2} nga rrezatimi diellor, ndërsa në zonat verilindore, si në Peshkopi, sasia e nxehtësisë arrin 120,000 kalori.cm^{-2}. Në pjesën pranësipërfaqësore, me rritjen e thellësisë zvogëlohet temperatura. Kjo ulje arrin deri në 9°C nga thellësia 5cm në 80cm [Gjoka L., 1990, Klima e Shqipërisë 1978].

Në rajonin fushor të vëndit, si në fushën e Tiranës (Rinas), në prerjen e depozitimeve kuaternare, në brezin e temperaturës konstante, të paktën deri në thellësinë 31m, ku është kryer regjistrimi, temperatura është rreth 15.5 °C (Fleta 8-a). Në këtë rajon ky brez ruan të njëjtën temperaturë gjatë të gjithë vitit. Ndryshime anësore të temperaturës, deri në masën 0.5°C, janë regjistruar edhe në largësi 500m, në të njëjtën ditë dhe orë. Kjo lidhet me ndryshimin e përbërjes litologjike të depozitimeve të shkrifta kuaternare. Në rajonet malore verilindore të Shqipërisë, është vrojtuar se brezi i temperaturës konstante vijon deri në thellësinë 50m, siç është rasti në prerjen e shkëmbinjve vullkanogjenë në zonën e Fushë-Arrëzit.

Në puse të ndryshme në zonat fushore dhe ato malore është vërejtur një zvogëlim i gradientit të temperaturës në krahasim me vlerën normale në pjesën pranësipërfaqësore të prerjes. Ky ndryshim shpreh ndikimet e paleoklimës.

Në gjysmën e parë e shekullit të XX-të, përgjithësisht është vrojtuar ngrohja e klimës, me rreth 1°C. Çereku i tretë e këtij shekulli u karakterizua nga një ftohje prej 0.6°C, dhe më pas deri në ditët tona është prezent ngrohja me rreth 1.2°C. Ndryshimi i klimës dhe prirja e ngrohjes kanë histori të temperaturës së truallit (HTT) të ndryshme në rajonet malore dhe fushore të vendit, madje edhe midis rajoneve fushore, në varësi të shpyllëzimeve dhe të gjendjes kënetore të trevës. Kjo ngrohje është pjesë e ngrohjes globale që po vrojtohet aktualisht në rruzullin e Tokës. Periudha e ngrohjes në Shqipëri është e shoqëruar edhe me ndryshime të regjimit të reshjeve atmosferike, të lagështisë dhe të shpejtësisë së erës. Është pakësuar për rreth (200-400)mm sasia vjetore e reshjeve. Këto ndryshime kanë patur impakt në pyjet, në sistemin ujor të vendit dhe në regjimin hidrografik të detit Adriatik [Frashëri A., 2001, Frashëri A. dhe Pano N. 2003, 2003]. Rritja e temperaturës ka filluar të ndikojë edhe në pjesë të pyjeve të vendit në zonat bregdetare dhe në brendësi të vendit. Në këto kushte, ndryshimet e llojeve bimore vihen re me shtimin e atyre llojeve që kërkojnë më pak ujë dhe durojnë më shumë thatësirën, si përshembull shkurret gjethevogla, marina, murrizi, gjineshtra etj. në zonën e Kuçovës, të Ballshit etj. Në zona të tjera, si në Divjakë, instalohen drurët halorë [Hasko H. 2003]. Në kuadrin e ngrohjes globale është e dukshme edhe prirja për zvogëlimin e sipërfaqeve të pyjeve.

Tabloja e fushës termale të Tokës në sipërfaqe, si edhe gradientet gjeotermale të vegjël në Albanide, kanë sjell që në thellësinë 100m temperaturat të jenë të ulëta nga 16°C deri në 18.8°C në zonën Jonike dhe në Ultësirën Pranadriatike (Fleta 7). Sektorët me temperaturë midis 18°C dhe 19°C ndodhen në Kolonjë-Divjakë-Kryevidh, Vlorë dhe Sarandë-Delvinë.

Duke analizuar hartën e temperaturës në thellësinë 100m, vihen re disa veçori:

Së pari, temperatura rritet drejt jugperëndimit dhe perëndimit, në ndryshim nga gradienti gjeotermal, i cili rritet drejt lindjes.

Së dyti, izotermat kanë në përgjithësi përvijëzim sipas shtrirjes së strukturave dhe të zonave tektonike të Albanideve, me drejtim veriperëndim-juglindje. Bën përjashtim nga kjo ecuri, përvijëzimi i izotermave në zonën e Alpeve Shqiptare, ku ato kanë drejtim pothuajse paralel me tërthoren Shkodër-Pejë.

Së treti, izoterma me vlerë të temperaturës 18°C, ashtu si edhe izogradientet, mbetet e hapur drejt veriperëndimit në shelfin e detit Adriatik. Edhe izoterma 16°C mbetet e hapur në këtë drejtim.

Fusha gjeotermale në thellësinë e Albanideve të jashtme karakterizohet nga vlera relativisht të ulëta të temperaturës, siç është karakteristikë e baseneve sedimentare me trashësi të madhe të depozitimeve. Në thellësinë 500m, temperaturat rriten deri në (21-25.7)°C (Fleta 9). Në Ultësirën Pranadriatike dhe në zonën Jonike temperatura arrin deri në 32.9°C në thellësinë 1000m (Fleta 10), 54°C në thellësinë 2000m (Fleta 11) dhe 71.8°C në thellësinë 3000m (Fleta 12).

Më thellë, temperatura rritet gradualisht, derisa arrin 105.8°C në thellësinë 6000m, të matur në strukturën e Ardenicës (Fleta 25).

Siç duket nga hartat e temperaturës së paraqitura në fletët 7, 9, 10, 11, 12, ecuria e izotermave, me përafrimin e parë, ruan drejtimin hapësinor të strukturave të Albanideve. Këto izoterma mbeten të hapura drejt veriperëndimit, në shelfin e detit Adriatik.

Në hartat e temperaturës vihet re që epiqendrat e temperaturave më të larta zhvendosen drejt verilindjes.

Krahas ndryshimeve krahinore të temperaturës, ekzistojnë edhe luhatje lokale anësore edhe në largësi 7-8km. Në Ultësirën Pranadriatike, në thellësinë 3000m janë fiksuar ndryshime të temperaturës deri në (8-9)°C në të tilla largësi. Ndryshimet më të mëdha anësore të temperaturës për nivelet, deri në 500m, janë fiksuar në rajonet e zonës tektonike Mirdita, duke filluar nga Rehova deri në Tropojë. Ky ndryshim i fundit shkaktohet kryesisht nga lëvizjet e ujërave të ftohta nëntokësore.

Shumë interes paraqet fusha e temperaturës në liqenin e Ohrit. Në profilin verior me drejtim lindje-perëndim në Piskopat, temperatura e matur në datën 4 shtator 1994, në thellësi 10m ka qenë 23.8°C dhe në drejtimin horizontal ndryshon në kufij të vegjël, deri në 0.5°C (Fleta 8-b). Temperatura ndryshon, madje me gradient të madh, në drejtim vertikal deri në thellësinë 40 m. Më thellë, praktikisht ajo ruhet konstante, në vlerën (7-8)°C. Në profilin e Gurit të Kuq, ku janë kryer sondime gjeotermale vihet re se izotermat, me përjashtim të ndonjë turbullimi të vogël, janë pothuajse horizontale dhe paralele me njera-tjetrën (Fleta 8-c). Përvijëzimi i tyre nuk kushtëzohet nga pjerrësia e fundit të liqenit.

4.1.2. Gradienti gjeotermal

Përhapja e fushës së gradientit gjeotermal të Albanideve në tërësi dhe e atyre të jashtme në veçanti, është e kushtëzuar plotësisht nga gjeologjia e zonave tektonike në plan krahinor dhe nga situacioni litologo-strukturor lokal (Fleta 13).

Në hartën e gradientit gjeotermal dallohen qartë disa rajone gjeotermale:

a) **Baseni Sedimentar Shqiptar**, i cili karakaterizohet me vlerë më të madhe të gradientit gjeotermal. Kështu, në pjesën argjilore të suitës Helmësi të pliocenit në qendrën e Ultësirës Pranadriatike, gradienti arrin në 21.3mK·m^{-1} (Fleta 14-a, 14-b). Gradienti gjeotermal, mesatarisht, ka madhësi rreth 15mK·m-1. Izolinja me vlerën e gradientit 15mK·m^{-1} ka përvijëzim pothuajse të ngjashëm me kufirin e Ultësirës dhe mbetet e hapur në drejtim të veriperëndimit, drejt shelfit të detit Adriatik. Ky gradient i vogël shpjegohet me trashësinë shumë të madhe, mbi 12000 m, të depozitimeve të Basenit Sedimentar Shqiptar.

b) **Brezi ofiolitik** karakterizohet nga gradiente gjeotermale, që luhaten në kufij të gjerë, nga (2 - 23.5)mk/m. Gradientet e vegjël shpjegohen me qarkullimin intensiv të ujërave nëntokësore, veçanerisht në masivet ultrabazike, çka vërtetohet me temperaturat e ulëta, në nivelin (7.0)°C deri në thellësi rreth 200m.

Duke analizuar në tërësi hartën e gradientit mesatar për brezin ofiolitik, vihet re rritje e gradientit drejt lindjes. Kjo rritje është e madhe, veçanërisht, drejt verilindjes në rajonin e Kukësit dhe juglindjes, në rajonin e Korçës. Gradienti më i madh 23.5mK·m^{-1} është regjistruar në masivin ultrabazik të Kukësit dhe Tropojës. Eshtë e rëndësishme të theksohet, se izolinja e gradientit me vlerë 20mK·m^{-1} këputet në sektorin e gjuhës flishore të Shën-Gjergjit, ashtu si edhe brezi ofiolitik, duke dëshmuar me këtë ndarjen e këtij brezi, të shprehur edhe në përhapjen e fushës së gravitacionit dhe atë magnetike. Vazhdimi jugperëndimor i tërthores Dibër-Elbasan-Vlorë, shprehet edhe në përvijëzimin e izolinjave të gradientit në zonën Jonike dhe në Ultësirën Pranadriatike.

c) **Zonat e gradienteve të vegjël**, me madhësi nga 5mKm^{-1} në zero ose madje negative, që janë Alpet shqiptare, rajoni Gjirokastrës dhe jug-lindja e Sarandës. Ndikim të fuqishëm në turbullimin e përhapjes së fushës termike dhe në ecurinë e temperaturës me thellësinë, ka lëvizja intensive e ujërave të ftohta sipërfaqësore deri në thellësitë e mëdha, (1000-2000)m, në prerjet gëlqerore në strukturat që kanë bërthama të zhveshura në sipërfaqen e tokës ose që shtrihen në thellësi të vogël. Kjo dukuri është fiksuar në strukturën e Kalcatit (Fleta 15-b), Erindit dhe Nokovës. Kështu, ndodh edhe në prerjet gëlqerore të Alpeve Shqiptare, ku deri në thellësinë 500m, ku është regjistruar temperatura, gradienti gjeotermal ka madhësi pothuajse zero mK·m^{-1}. Por, për të dy këta rajone vërehet se izolinjat e gradienti gjeotermal në jug të zonës Jonike kanë përvijëzim që përputhet me shtrirjen e brezave strukturorë. Në veri, në zonën e Alpeve dhe në atë të Krasta-Cukalit izolinjat janë pothuajse paralele me tërthoren Shkodër-Pejë.

d) **Rajoni Fushë - Krujë - Tiranë - Elbasan - Gramsh**, ku gradienti gjeotermal është relativisht i vogël, i nivelit rreth 10mk/m, që ka mundësi të kushtëzohet me praninë e diapireve kripore, që deformojnë përhapjen e fushës termike të Tokës. Në fletën 15-a tregohet profili gjeotermal i pusit në zonën e Paprit, ku nën prerjen flishore të oligocenit shtrihen kripërat e diapirit të Dumresë. Në intervalin (1600-3000)m, pusi ka kaluar nëpër kripë, e cila ka përcjellshmëri termike të lartë, prandaj edhe gradienti gjeotermal është më i vogël, sesa në pjesën tjetër të prerjes.

Në pjesën veriore të zonës Kruja, gradienti gjeotermal është më i vogël, ai ka madhësi rreth 12.5mK·m^{-1}. E kundërta ndodh në sektorin jugor ku gradienti rritet deri në 20mK·m^{-1}. Kjo rritje lidhet me ndikimin e fluksit gjeotermal të rritur në jugun e brezit ofiolitik.

Gradienti gjeotermal kushtëzohet nga tektonika dhe litologjia e prerjes gjeologjike të rajonit.

Vlera më të larta të gradientit gjeotermal janë fiksuar në strukturat antiklinale molasike të katit të sipërm strukturor, si në Divjakë (Fleta 14-a, 14-b). Në vargjet antiklinale me bërthama gëlqerore ku ka qarkullim të ujërave nëntokësore, gradientet gjeotermale kanë madhësi më të vogël në krahasim me pjesën e prerjes flishoidale. Gradienti gjeotermal zvogëlohet mesatarisht në masën (10-20)%, madje edhe më shumë, deri në 24%, siç është rasti i strukturës së Ballshit, ku gradienti në thellësinë (700-800)m karshi prerjes flishore të oligocenit ka vlerë 13.5mK·m^{-1}. Në prerjen gëlqerore të jurasikut deri në eocen, gradienti zvogëlohet deri në 11.5mK·m^{-1} (Fleta 14-c). Gradienti merr vlera të vogla, (7-10)mK·m^{-1}, në brezat e thellë sinklinale të zonës Jonike dhe zonës Kruja.

Litologjia e prerjes gjeologjike kushtëzon ecurinë anomale lokale të gradientit gjeotermal. Kjo lidhet me faktin se shkëmbinjtë me përbërje të ndryshme litologjike kanë përcjellshmëri termike të ndryshme. Tipike për këtë dukuri është prerja Pliocenike e pusit Povelça-3 (Fleta 15-c). Siç duket nga kjo figurë pjesa konglomeratiko-ranorike e suitës Rrogozhina, ku ranorët zënë 65% të prerjes, ka gradient gjeotermal mbi dy herë më të vogël se prerja argjilore e suitës Helmësi.

Albanidet e jashtme kanë gradient gjeotermal të ngjashëm edhe me të Dinarideve, të cilat gjithashtu, karakterizohen nga gradient relativisht i vogël, mesatarisht 15 mK·m^{-1} [Ibrahimpasic. J 1983, Milivojeviç G. M. 1993, Ravik D. dhe Rajner D. 1993], dhe me të pjesës veriore të Helenideve, ku gradienti gjeotermal është rreth 12 mK·m^{-1} [Fytikas M, Kolios N.P.], si edhe me shelfin shqiptar të Adriatikut (18.4-19.7)mK·m^{-1} [Atlasi Gjeotermal i Europës 1992]. Përputhje e mirë konstatohet edhe me të dhënat gjeotermale të Maqedonisë [Georgievna M. 2003, Micevsky E. 2003].

Në madhësinë e gradientit gjeotermal ndikon edhe shfaqja e trysnive të larta anomale. Duke filluar nga zona kalimtare deri në thellësinë e shfaqjes së trysnive të larta anomale, ekzistojnë anomali termike lokale të qarta. Temperatura rritet me hop në masën (5-10)°C (Fleta 15-d) [Hoxha Xh. 1984, Liço R. etj., 1998].

Në përhapjen e fushës termale ekzistojnë ndikime anësore, të cilat janë të mëdha veçanërisht kur në afërsi me pusin ku regjistrohet temperatura shtrihen struktura karbonatike ku qarkullojnë ujëra nëntokësore. Kështu, në pusin e thellë Ardenica-18, deri në thellësinë 2500m, gradienti gjeotermal mesatar ka madhësi 15.4mK·m^{-1}. Nën nivelin 3000m gradienti zvogëlohet deri në 13.1mK·m^{-1}; kjo ndodh sepse në lindje të këtij pusi, në të njejtën thellësi shtrihet struktura karbonatike e Patos-Verbasit (Fleta 25).

Modelimet gjeotermale kanë treguar se në Albanidet e jashtme, vlerat e gradientit gjeotermal (15-21.3)mK·m^{-1} ruhen deri në thellësinë 20km. Më thellë, gradienti zvogëlohet. Ky ndryshim i madhësisë së gradientit gjeotermal përputhet me tavanin e bazamentit kristalik. Ndërsa në Albanidet e brendshme gradienti gjeotermal zvogëlohet më thellë se 12000 m, me tavanin e evaporiteve triasike (Fleta 4-a).

4.1.3. Dendësia e fluksit të nxehtësisë

Fusha e dendësisë së fluksit të nxehtësisë, ashtu si edhe ajo e gradientit gjeotermal, paraqet disa karakteristika, që lejojnë të veçohen disa zona (Fleta 16).

Baseni Sedimentar Shqiptar, në qendrën e Ultësirës Pranadriatike, dendësia e fluksit të nxehtësisë është deri në 41.3mW/m^2. Izoterma 30mW/m^2 mbetet e hapur drejt shelfit shqiptar të detit Adriatik, ku dendësia e fluksit arrin deri në 35.7 dhe 38.2mW/m^2, në largësi 50km nga Durrësi dhe 35km nga Vlora, ku janë shpuar dy puse të thellë nafte e gazi. Në veriperëndim të Durrësit, në shpatin kontinental të Adriatikut lokalizohet një anomali e dendësisë së fluksit të nxehtësisë me amplitudë 100mW/m^2 [Geothermal Atlas of Europe, 1992].

Në diapirin kripor të Dumresë dhe të Xarës në Sarandë, dendësia e fluksit të nxehtësisë ka, përkatësisht, madhësi 37 mW/m^2 dhe 27 mW/m^2.

Brezi ofiolitik karakterizohet nga dendësi më e lartë e fluksit të nxehtësisë, që luhatet nga 40mW/m^2 në Rehovë të Korçës, 48.3mW/m^2 në Bulqizë dhe deri në 61.8mW/m^2 në Keçël të masivit ultrabazik të Kukësit. Edhe në masivin ultrabazik të Tropojës, dendësia e fluksit arrin 47.2mW/m^2. Deri në 47mW/m^2 arrin dendësia e fluksit të nxehtësisë edhe në Mirditën Qendrore, në venburimin e bakrit të Perlatit. Izotermat me vlera (35; 40; 45)mW/m^2 përvijojnë mirë brezin ofiolitik. Izotermat me vlera 45mW/m^2 në verilindje dhe me vlerë 40mW/m^2 në juglindje mbeten të hapura në drejtim të vazhdimit të brezit ofiolitik tej kufijve shtetërore të Republikës së Shqipërisë. Vlerat më të larta të dendësisë së fluksit të nxehtësisë në brezin ofiolitik, në krahasim me Albanidet e jashtme, shpjegohen me vendosjen më cekët të tavanit të bazamentit kristalin, ku shtrihen shkëmbinj që gjenerojnë nxehtësi si rrjedhojë e zbërthimit të elementeve radioaktivë [Frashëri A. 2000].

Në brezin ofiolitik janë fiksuar disa vatra me vlera të larta të dendësisë së fluksit të nxehtësisë. Këto anomali të fluksit të lartë lidhen me transmetimin intensiv të nxehtësisë nëpër thyerjet e thella tërthore, dhe veçanërisht në nyjet e ndërprejes së tyre me thyerjet e thella gjatësore. Këto thyerje kushtëzojnë edhe burimet e energjisë gjeotermale. Kjo tablo e përhapjes së fushës gjeotermale, ashtu si edhe ato të fushës së gravitacionit dhe magnetike, argumentojnë ndërtimin bllokor të bazamentit kristalin në Albanidet. Thellësia e tavanit të këtyre blloqeve është më e vogël në zonën tektonike Mirdita.

Në Alpet Shqiptare, dendësia e fluksit të nxehtësisë është shumë e vogël. Ajo ka madhësi që arrijnë deri në 10mW/m^2, çka shpjegohet me thellësinë e madhe, (50-60)km, të kufirit MOHO, si edhe me prerjen e trashë karbonatike, e cila gjeneron pak nxehtësi, në mungesë të përmbajtjes së elementeve radioaktive.

4.2. Burimet ujore të energjisë gjeotermale

4.2.1. Burimet dhe puset gjeotermale

Shqipëria ka shumë burime të ujërave termale (Pasqyra 4, Fleta 17). Këto burime njihen qysh në lashtësi. Në fshatin Bënjë të Përmetit ka burime termale në shtratin e lumit të Langaricës, të mirënjohura qysh në kohën e Perandorisë Romake, dhe vetë fshati emrin e ka marrë nga fjala “banjë” (Fleta 23-b).

Burimet termale të Llixhave të Elbasanit, gjithashtu janë të njohura qysh në atë kohë dhe në vitin 1932 atje është ndërtuar një qendër balneologjike moderne për kohën “Hotel Park”, që funksionon edhe në ditët tona me të njëjtën teknologji (Fleta 22-b, 28-a).

Në malin e Postenanit, në veri të Leskovikut, shfaqen burime avulli. Edhe këto burime janë shfrytëzuar nga banorët vendas për të bërë banja dhe për të mjekuar sëmundje të ndryshme.

Edit’h Durham, në librin “The Burden of the Balkans”, botuar në vitin 1905, shkruan: *“Përgjatë një shkëmbi, jo larg nga fshati, gjendet një burim sulfidrik, ... Burimi vlerësohet shumë për mjekime të reomatizmit…”.*

Që nga ajo kohë, burimet unikale të avullit në Shqipëri, mbetën jashtë vëmendjes së specialistëve dhe nuk janë pasqyruar në literaturën gjeologjike. Në verën e vitit 2003, Alfred Frashëri, Neki Frashëri dhe Ilir Mati, vajtën në Postenan dhe kryen vrojtime e fotografime [N. Frashëri, I. Mati, 2003] (Fleta 24-a, 24-b). Për këto burime avulli ka shkrojtur edhe gjeografi Meçaj N. në librin e tij (2003). Janë të mirënjohura burimet termale të Vromonerit në bregun e lumit Sarandaporo në Leskovik (Fleta 24-c) dhe të Peshkopisë (Fleta 26-b).

Gjatë gjysmës së dytë të shekullit të kaluar ka fontanuar ujë i nxehtë edhe nga disa puse të thellë të shpuar për kërkimin e naftës e të gazit (Pasqyra 5, Fleta 17).

Potenciali ujor nëntokësor i Shqipërisë dallon nga këto karakteristika kryesore:

· Volumi i përgjithshëm i potencialit ujor nëntokësor është i barabartë me W_N = 12.8km^3.

· Shtresa ujore e rrjedhjes nëntokësore si mesatare për të gjithë territorin arrin në Y_N = 295mm.

· Moduli i rrjedhjes ujore nëntokësore si mesatare për të gjithë territorin ka madhësi q_N = 9,5 l/sek.km^2.

Potenciali ujor nëntokësor përbën 31% të potencialit të përgjithshëm ujor të Shqipërisë.

Rrjedhja ujore gjatë shpërndarjes së saj gjeografike në territorin e vendit përfaqëson përkatësisht (10–60)% të rrjedhjes totale. Natyra e kësaj shpërndarje përcaktohet kryesisht nga kushtet fiziko-gjeografike të territorit dhe përkatësisht nga sasitë e rreshjeve atmosferike të rëna, nga evotraspiracioni si dhe nga struktura litologjike e territorit.

Deri sot, ujërat termale janë shfrytëzuar vetëm për qëllime kurative të sëmundjeve të ndryshme.

Në Shqipëri, njihen vetëm burime dhe puse të ujërave termale të entalpisë së ulët, temperaturat e disa prej tyre janë pothuajse në kufijtë e sipërm të entalpisë së ulët, duke arritur në 60°C në llixhat e Elbasanit dhe në pusin Ishmi-1/b, dhe 65.5°C, në pusin Kozani-8 (Fleta 21-a, 21-b). Prania e burimit të avullit, duket se janë premisat gjeologjike që të gjenden edhe burime gjeotermale të entalpisë së mesme, me temperaturë mbi 80°C.

4.2.2. Zonat gjeotermale

Burimet dhe puset e ujërave termale në Shqipëri janë të lokalizuar në tri zona gjeotermale (Fleta 17):

1. Zona Gjeotermale Kruja
2. Zona Gjeotermale Ardenica
3. Zona Gjeotermale Peshkopia

Tri zonat gjeotermale kanë veçori gjeologjike dhe termo-hidrogjeologjike të ndryshme.

Përveç këtyre, ka edhe burime të veçanta në zona të tjera si: në fshatin Kapaj në Mallakastër, në Selenicë të Vlorës dhe në Krane në lindje të qytetit të Sarandës; por ujërat e këtyre burimeve kanë temperatura relativisht të ulëta (Pasqyra 4).

KATALOGU I BURIMEVE TERMALE NË SHQIPËRI

Pasqyra 4

Nr	**Emri i burimit dhe rajonit**	Temp. **°C**	Koordinatat Gjeografike		Debiti **l/sek**
			Gjeresi V	Gjatesi L	
1	Mamuras 1 dhe 2	21-22	41°35'24"	19°42'48"	11.7
2	Shupal	29.5	41°26'9"	19°55'24”	<10
3	Llixha Elbasan	60	41°02'	20°04'20"	15
4	Hydrat, Elbasan	55	41°1’20"	20°05’15"	18
5	Peshkopi	43.5	41°42'10"	20°27'15"	14
6	Ura e Katiut Langaricë, Permet	30	40°14'36"	20°26’	>160
7	Vromoneri, Sarandoporo, Leskovik	26.7	40°5'54"	20°40'18"	>10
8	Finiq, Sarande	34	39°52'54"	20°03’	<10
9	Përroi i Holtes, Gramsh	24	40°55'30"	20°09'24"	>10
10	Postenan, Leskovik	Burim avulli	40°10’24"	20°33’36"	
11	Kapaj, Mallakastër	16.9-17.9	40°32’30"	19°48’42"	12
12	Selenicë, Vlorë	35.3	40°32’18"	19°39’30"	<10

Zonat gjeotermale lidhen me tektonikën shkëputëse krahinore dhe me brezat sizmologjikë aktive (Fleta 18, 19).

4.2.2.1. Zona Gjeotermale Kruja

Zona gjeotermale Kruja është një zonë e madhe që shtrihet në rreth 180km dhe ka një gjerësi (4-5)km (Fleta 17, 20). Ajo fillon në bregdetin e Adriatikut, në veri të Kepit të Rodonit, vazhdon me strukturat e Ishmit, të Kozanit në veri të Elbasanit, të Llixhave të Elbasanit, të Holtës, të Bënjës në përroin e Langaricës të Postenanit në Leskovik dhe të Sarandaporos në afërsi të kufirit shqiptaro-

KATALOGU I PUSEVE TERMALE NË SHQIPËRI

Pasqyra 5

Nr.	Pusi	Temp. në **°C**	Koordinatat		Debiti **l/sek**
			Gjerësi **V**	Gjatësi **L**	
1	Kozani 8	65.5	41°06'	20°01'6”	10.3
2	Ishmi 1/b	60	41°29.2'	19°40.4'	3.5
3	Letan	50	41°07'9”	20°22'49”	5.5
4	Galigati 2	45-50	40°57'6”	20°09'24”	0.9
5	Bubullima 5	48-50	41°19'18”	19°40'36”	
6	Ardenica 3	38	40°48'48”	19°35'36”	15-18
7	Semani 1	35	40°50'	19°26	5
8	Semani 3	67	40° 46'12”	19°22'24”	30
9	Ardenica 12	32	40°48'42”	19°35'42”	
10	Verbasi 2	29.3			1-3

grek. Përtej kufirit, zona Kruja vazhdon më në jug me burimet e Kavasilës në zonën e Konicës në Greqi [Frashëri A. et., 2003, Fytikas M. D. etj. Taktikos S. 1993].

Zona Gjeotermale Kruja përfaqëson një varg strukturash antiklinale, me bërthama karbonatike të moshës së kretakut - eocenit. Gelqerorët vazhdojnë me flishin oligocenik. Prerja flishore ka trashësi deri në 5km. Në disa struktura në veri të zonës, si në atë të Ishmit, drejtpërsëdrejti mbi gëlqerorët e shplarë vendosen transgresivisht molasat e tortonianit. Në struktura të tjera, si në Kozan, mbi prerjen flishore, transgresivisht shtrihen mergelet e burdigalianit.

Formacioni karbonatik përfaqësohet nga gëlqerorë neritikë, gëlqerorë dolomitikë dhe dolomite. Gëlqerorët janë me çarje dhe mikroçarje të shumta dhe të karstëzuar. Antiklinalet janë lineare, me gjatësi deri në (20-30)km. Ato janë asimetrike dhe krahët e tyre perëndimore janë të këputur nga tektonika disjunktive. Ka edhe antiklinale të përmbysur dhe të mbihedhur drejt perëndimit. Vargu i strukturave me ujëra të nxehta përfaqëson, kryesisht, buzinën perëndimore të zonës tektonike Kruja. Strukturat e buzës perëndimore të zonës Kruja vendosen mbi strukturat e zonës Jonike, nëpërmjet tektonikës mbihipëse krahinore (Fleta 4-a).

Tektonikat mbihipëse krahinore të Albanideve, nga thellësi të mëdha, arrijnë e zhvishen në sipërfaqe. Disa prej tyre prekin të gjithë koren sedimentare. E tillë është edhe tektonika më perëndimore e zonës tektonike Kruja. Në plan krahinor, gëlqerorët dhe flishi i zones Kruja zhyten deri në thellësi rreth 10km, ku ato vendosen mbi formacionin evaporitik triasik. Në këto nivele, temperatura arrin (120-150)°C (Fleta 4-a). Në këtë brez, është e rëndësishme edhe prania e tektonikës që lidhet me formacion evaporitik.

Temperaturat e akuiferit, të vlerësuara sipas përbërjes kimike të ujërave termale të disa burimeve, me anën e gjeotermometrave Fournier, Truesdell dhe Na+K+Ca jepen në pasqyrën 6.

TEMPERATURA E AKUIFERIT E VLERËSUAR SIPAS GJEOTERMOMETRAVE

(në gradë Celsius)

Pasqyra 6

		Burimet ne Mamurras	
Gjeotermometri	Burimi "NOSI" Llixha Elbasan	Burimi 1	Burimi 2
Fournier	254	214	220
Truesdell	235	184	191
Na+K+Ca	143	130	132

Këto rezultate tregojnë se uji vjen nga thellësi të mëdha, ku mjedisi ka temperaturë të lartë, (150-200)°C. Uji i nxehtë ngjitet lart, kryesisht, nëpërmjet shkëmbinjve të shkatërruar të zonave tektonike dhe ngop çarjet e kolektorit karbonatik në Ishëm, po ashtu në Kozan, kur krijohet depresion në pus për përvetësim dhe gjatë fontanimit, ose buron si në Llixhat e Elbasanit, në Holtë, Bënjë, Postenan dhe Sarandaporo.

Në Fletën 20 paraqiten karakteristikat gjeologo-gjeofizike për strukturën dhe pusin Ishmi-1/b, e cila është struktura gjeotermale më veriore. Pusi Ishmi-1/b, ndodhet rreth 20km në veriperendim të Tiranës (Fleta 21-a). Uji nga pusi del me temperaturë 60°C dhe ka mineralizim 19.3g/l. Uji termal përmban <1.2TU tritium (^3H) dhe -6.73$‰_o$ SMOW të d^{18}O. Mungesa e tritiumit tregon se uji termal është formuar më tepër se shumë shekuj më parë (Mebus A. Geys, 1996). Ai fontanon nga një interval me trashësi prej 5m, në thellësinë (2200 – 2205)m. Sipas diagramës të rezistencës së dukshme, ky interval përfaqësohet nga gelqerorë me rezistencë elektrike specifike të vogël, që tregon se ata janë të shkatërruar nga dukuritë tektonike dhe karstike. Sipas regjistrimit të temperaturës në pus, temperatura është 42°C në thellësinë ku shtrihen gëlqerorët. Ky ndryshim midis temperaturës së ujit termal që fontanon në sipërfaqe dhe prerjes së gëlqerorëve në thellësi, tregon se fontanon përzierje uji nga thellësi dhe me temperaturë të ndryshme. Uji i nxehtë rrjedh drejt sipërfaqes nëpër tektonikën shkëputëse të krahut perëndimor të strukturës dhe nëpër çarjet e gelqerorëve rrjedh në pus. Debiti i këtij pusi, 3.5l/sek, është i qëndrueshëm gjatë një periudhë tridhjetë vjeçare, qysh nga viti 1964, kur uji i nxehtë fontanoi për herë të parë. Në Ishmi-1/b, fuqia e mundshme për tu instaluar është 644kW.

Një pjesë e këtij uji, përmes sipërfaqes së shplarë të tortonianit dhe tektonikës, buron në Mamuras, me temperaturë 21°C, i përzierë edhe me ujëra meteorite. Mineralizimi i ujit është 5.4g/l, TDS 6.8 g/l, dhe përmban 330mg/l H_2S dhe 0.18g/l C_2O të lirë (Avgustinskij V.L., 1957). Uji i burimit Nr. 2 përmban 6.4TU tritium (^3H), rrjedhimisht është formuar pas vitit 1963 [Mebus A. Geys, 1996].

Në grykën e pusit Kozani-8, që është një ndër puset e shpuar në strukturën e Kozanit (Fleta 20, 21-b) uji ka temperaturë të lartë (65.5°C). Pusi ndodhet në juglindje të Tiranës, rreth 35km. Ai ndodhet vetem 8km në veriperendim të Elbasanit. Uji del nga një horizont në thellësinë (1816-1837)m. Temperatura e ujit është 80°C, kurse trysnia 191 atmosferë në tavanin e gëlqerorëve në fund të pusit, si dhe 12 atmosferë në grykën e tij. Mineralizimi i ujit 4.6g/l. Debiti është i qëndrueshëm, 10.3l/sek. Fuqia e mundshme për tu instaluar është 2070kW. Faktori i kapacitetit termik 1.93MWt. Sipas diagramës së rezistencës së dukshme, në intervalin (1816-1837)m, shtrihen gëlqerorë kompaktë, me rezistencë elektrike specifike të lartë.

Në jug të pusit Kozani-8 dhe të qytetit të Elbasanit, në luginën e Shirjanit, ndodhen shtatë burimet termale të mirënjohura të Llixhave të Elbasanit dhe të Hydratit (Fleta 22-a, 22-b). Uji i tyre ka temperaturë dhe debite të larta, (55-60)°C dhe prurje të përgjithshme përkatësisht 15 dhe 18 l/sek, (Pasqyra 6). Uji i nxehtë ka mineralizim të përgjithshëm 7.2 g/l, TDS 6.8 g/l, H_2S 410 mg/l dhe 180 mg/lCO_2 të lirë.

Uji i burimit Nosi ka formule [Avgustinskij V.L. 1957]:

$$H_2S_{0.04}^{Pergj\cdot}M_{71}\frac{Cl_{59}SO_{38}^{4}}{Na_{46}Ca_{35}}$$

Ashtu si uji termal i pusit Ishmi-1, edhe uji termal i burimit Nosi përmban <1.2 TU tritium (^3H) dhe -7.66$\%_0$ SMOW të d^{18}O. Mungesa e tritiumit tregon se edhe ky ujë termal është formuar më tepër se shumë shekuj më parë [Mebus A. Geys, 1996]. Të dy këta ujëra kanë origjinë të njëjtë.

Ujërat termale të rajonit Elbasan-Tiranë janë të tipit kloro-magnezial. Përmbajnë katione Ca–, Mg–, Na^+ dhe K^+, anione Cl^-, SO_4^-, HCO_3^- etj., kanë pH=6.7-8 dhe dendësi 1.001 deri në 1.006g/cm^3.

Tablo e ngjashme gjeologjike është edhe në strukturën ku ndodhet pusi Galigati- 2, që ndodhet rreth 18km në juglindje të Elbasanit. Nga balli i gëlqerorëve në thellësi 2900m, ka fontanuar ujë me temperaturë (45-50)°C. Në këto thellësi, temperatura e gëlqerorëve është 46.4°C, që tregon se edhe atje, uji vjen nga thellësitë. Pusi Galigati-2 është i likuiduar. Më në jug të pusit Galigati-2, ndodhen burime termale në Përroin e Holtës, ku temperatura është 24°C.

Në pjesën jugore të zonës gjeotermale Kruja ndodhen burimet termale të Urës së Katiut, në përroin e Langaricës (Fleta 23-a, 23-b), burimet e avullit në malin e Postenanit në veri të Leskovikut [Fleta 24-b, 24-c] dhe burimi i ujit në shpatin verior të lumit Sarandaporo në grykën e Vromonerit, në jug të Leskovikut, pranë kufirit shqiptaro-grek [Fleta 24-c]. Në vazhdim të këtij brezi, në Kavasila të Greqisë, uji termal buron në shpatin e majtë të lumit Sarandaporo.

Në Bënjë, ka tetë burime me temperaturë nga 23 deri në 30°C dhe me prurje (8 deri >40)l/sek, secili. Burimet që ndodhen në anën e djathtë të lumit kanë temperaturë më të ulët, (23-26)°C dhe mineralizim 1.3g/l, ndërsa burimet që burojnë në shpatin e majtë të lumit kanë temperaturë më të lartë, 30°C dhe mineralizim 1.65g/l. Mesatarisht, ujërat e Bënjës kanë TDS 1.568 g/l, dhe nuk përmbajnë ose përmbajnë shumë pak H_2S (burimi Nr.5 përmban 0.0042 g/l), CO_2 të lirë (0.0384 g/l) dhe H_2SiO_3 (0.0163 g/l).

Uji ka fomulë (Avgustinskij V.L. 1957):

$$M_{(1.3-1.65)}\cdot\frac{Cl_{(67-75)}}{Na_{65}\cdot Ca_{24}}$$

Uji i disa burimeve është i pijshëm dhe me efekte kurative.

Avulli në malin e Postenanit del në një çarje tektonike, me temperaturë (47-54)°C, në varësi të vendit ku matet. Avulli kondenson në bulëza uji. Analizat mungojnë.

Në kodrat e shpatit të djathtë të lumit Sarandaporo, në Gryklën e Vromonerit, uji termal buron me temperaturë 27.6°C dhe me mineralizim të ulët, si uji i Bënjës. Ky ujë mineral është i pijshëm dhe me efekte kurative.

Ujërat vijnë nga thellësia, nëpër tektonikën shkëputëse, përkatësisht të antiklinalit me bërthamë gëlqerore eocenike të Langaricës, atë të Leskovikut dhe antiklinalit të Kavasilës. Këta antiklinalë përfaqësojnë pjesën më të jashtme të zonës Kruja, në vargun antiklinal të Tomorit. Antiklinali i Kavasilës në territorin shqiptar ka vetëm periklinalin verior, ku ndodhet edhe burimi i Sarandaporos. Temperaturat e burimeve të trevës Përmet-Konicë janë më të ulëta, sesa të burimeve të llixhave

Elbasan-Ishëm, në pjesën veriore të zonës Gjeotermale Kruja, pasi në jug të Shqipërisë bërthamat e strukturave gëlqerore janë pranë sipërfaqes së tokës ose madje të zhveshura. Nëpër gëlqerorët kavernozë dhe me çarje qarkullojnë ujërat e ftohta nëntokësore, të cilat futen edhe në thellësi të mëdha, siç tregohet për pusin Kalcat (Fleta 14-d). Këto ujëra ftohin ujërat termale dhe zvogëlojnë kripshmërinë e tyre. Kjo hipotezë mbështetet edhe nga prania e burimeve të avullit në antiklinalin e Leskovikut, në malin e Postenanit.

4.2.2.2. Zona Gjeotermale Ardenica

Zona Gjeotermale Ardenica ndodhet në rajonin e Myzeqesë, në lindje, veri dhe perëndim të qytetit të Fierit (Fleta 17, 25). Ajo shtrihet në skajin jugperëndimor të tërthores Vlorë-Elbasan-Dibër. Në këtë zonë bën pjesë struktura molasike neogjenike brakiantiklinale e Ardenicës, antiklinali i Semanit, periklinali verior i strukturës karbonatike të Patos-Verbasit dhe mbi të molasat neogjenike, në sektorin e Verbasit të monoklinalit të Patosit.

Rezervuaret gjeotermale janë kolektorë ujëmbajtës që i përkasin formacionit molasik neogjenik. Ata përfaqësohen nga një seri shtresash ranore të moshës së serravalian-tortonian-mesinianit, të cilat ndahen nga shtresa argjilash e alevrolitesh. Në pusin Bubullima-5, uji vjen në sipërfaqe nga gëlqerorët e strukturës së Patos-Verbasit. Në brakiantiklinalin e Ardenicës kanë fontanuar ujë të nxehtë puset e thellë; Ardenica-3 dhe Ardenica-12; në antiklinalin e Semanit kanë fontanuar puset Semani-1 dhe Seman-3 dhe pusi Verbas-2 në monoklinalin e Patosit. Këto struktura janë të prekura nga tektonika shkëputëse.

Në strukturën e Ardenicës, prerja ranorike ka trashësi nga (445-1165)m dhe përhapet në të gjithë strukturën. Trashësia e prerjes ujëmbajtëse është rreth 900m, e cila në pusin Ardenica-12 fillon nga 1095 deri në 1955m. Shtresat e ranorëve ujëmbajtës kanë trashësi nga disa deri në (15-20)m. Vetëm nga thellësia (1870-1950)m, trashësia e përgjithshme e shtresave ranore arrin 55m. Nga gryka e këtij pusi ka fontanuar ujë i nxehtë me temperaturë 32°C. Uji ka ardhur nga dy shtresa: e sipërmja me trashësi 7m me tavan në thellësinë 1935 dhe e poshtmja me trashësi 5m me tavan në thellësinë 1951m.

Uji termal është i tipit kloro-kalcium dhe ka formulë:

$$M_{58.8}\frac{Cl_{98}}{Na_{86}}$$

Uji i fontanuar nga pusi Ard-3 përmban 21.2mg/l jodium, 110mg/l bromium dhe 71mg/l acid borik. Uji nuk përmban H_2S. Temperatura e tij është 45.8°C në thellësinë 1940m të strukturës së Ardenicës, ku ndodhet shtresa e sipërme ujëmbajtëse e pusit Ardenica 12 (Fleta 25). Por, në sipërfaqe uji ka fontanuar me temperaturë 32°C. Duke ditur se uji ftohet me një gradient rreth (1-1.4)°C/100m, gjatë ngjitjes së tij për në grykën e pusit, rezulton se uji në shtresë duhet të ketë patur temperaturë rreth 59)°C.

Pusi Semani-1 ka dhënë ujë me temperaturë 35°C nga shtresa ranore ujëmbajtëse, me trashësi 10m dhe 5m, në thellësinë (2052–2075)m. Në këto thellësi, temperatura e strukturës është rreth 48°C. Duke patur parasysh ftohjen gjatë fontanimit, ujërat kanë afërsisht temperaturën 63°C në shtresë.

Pusi Semani-3 ka fontanuar ujë me temperaturë 38°C në grykë, me prurje 7l/sek dhe trysni 457atm. nga intervali (2698-2704)m; ndërsa nga thellësia 3758m ka fontanuar ujë me temperaturë 67°C, prurje 30l/sek, trysni të shtresës 770atm. dhe trysni 200atm në tubing. Duke patur parasysh ftohjen e ujit gjatë fontanimit, ujërat kanë afërsisht temperaturën 100°C në shtresën e poshtme.

Këta puse, të ndodhur, në zonën e tërthores krahinore Vlorë - Elbasan-Dibër, kanë ndikimin e ujit të nxehtë që qarkullon nga thellësitë e mëdha. Kjo, si edhe temperaturat më të larta në tavanin e zonës me trysni mbinormale, lejojnë që të prognozohet ekzistenca edhe e shtresave të tjera ujëmbajtëse në Ultësirën Pranadriatike, në të cilat ujërat kanë temperatura më të larta.

4.2.2.3. Zona Gjeotermale Peshkopia

Zona Gjeotermale Peshkopia ndodhet në verilindje të Shqipërisë, në zonën hidrogjeologjike të Korabit. Dy kilometra në lindje të qytetit të Peshkopisë, në përroin e Banjës ndodhen katër burime pranë njëri-tjetrit (Fleta 17, 26-a, b) [Çollaku A. etj. 1992]. Këto burime lidhen me tektoniken e diapirit gjipsor triasik, i cili rrethohet nga një unazë e flisheve të eocenit të sipërm-oligocenit të poshtëm. Burimet lidhen me brezin tektonik sizmoaktiv Liqeni i Ohrit-Dibër. Me këtë brez tektonik lidhen edhe burimet termale të Banjishtes dhe të Kosovrastit në veriperëndim të Dibrës në Maqedoni [Frashëri A dhe Pano N. 2003, Micevsky E. 2003].

Disa prej burimeve në Peshkopi japin ujë të nxehtë me temperaturë 43.5°C, ujrërat e burimeve të tjerëve janë më të ftohtë, deri në 12°C. Burimet kanë prurje të madhe; midis tyre, ai që ka temperaturën e lartë ka prurje 14 l/sec. Ujërat termale burojnë aty ku gjipset zhyten nën nivelin e zonës së qarkullimit të lirë të ujit, duke qenë të lidhur me zonën e qarkullimit të ulët, kudo nën presionin e ujit. Kur gjipset zhyten nën nivelin e zonës së qarkullimit të lirë të ujit, vërehet prania e H_2S.

Mineralizimi i përgjithshëm i ujit të burimit me temperaturë 43.5 °C është 4.3677 g/l, TDS 4.05 g/l, përmban 495 mg/l H_2S, 540 mg/l CO_2 të lirë dhe ka formulë [Avgustinskij V.L. 1957]:

$$H_2S_{0.0495}M_{4.4}\frac{SO_{56}^{4}}{Ca_{65}}$$

Ai përmban katione Ca, Mg, Na dhe K, anione Cl, SO_4, HCO_3 dhe sasi shumë të vogla F, Br, HCO_3 etj. Uji i burimit të dytë përmban shumë pak H_2S, 32 mg/l. Për ujin e burimit me temperaturë 43.5°C, sipas gjeotermometrave të Fournier, Truesdell dhe Na+K+Cl, temperatura e përllogaritur e akuiferit është 220°C, 270°C dhe 144°C. Mbështetur në madhësinë e gradientit gjeotermal të rajonit, mund të pranohet që ujërat termale vijnë nga thellësia (8-12)km, ku temperatura arrin deri në 220°C. Por, duke supozuar se diapiri evaporitik ka trashësi (3-4)km dhe shkëmbinjtë halogjenë janë përcjellës të mirë të nxehtësisë, dendësia e fluksit të nxehtësisë duhet të jetë më e madhe në thellësi më të vogla. Në këto kushte, mund të supozohet që ujërat mund të nxehen edhe në thellësi më të vogla.

4.2.3. Rezervat e burimeve të energjisë gjeotermale

Zonat Gjeotermale të Shqipërisë përfaqësojnë territore të gjera, me rezerva të mëdha të energjisë gjeotermale. Këtë e vërtetojnë burimet e shumta termale dhe puset e thellë të naftës që fontanojnë ujë të nxehtë, si dhe rezervat gjeotermale të llogaritura.

4.2.3.1. Zona Gjeotermale Kruja

Struktura më veriore e zonës gjeotermale Kruja, antiklinali i Ishmit, ka prerje karbonatike që karakterizohet nga një rezistencë elektrike specifike e dukshme e vogël, që luhatet në kufijtë 50 deri 20 Omm (Fleta 20). Kjo tregon për veti të mira kolektore, si dhe për ngopjen e kolektorit me ujë të mineralizuar. Në këtë prerje ndërthuren gëlqerorët kompaktë me ato që janë kolektore. Këto ndërshtresa kanë trashësi 5-10m. Poroziteti efektiv i tyre ka madhësi $5.8\text{-}7.10^{-3}$ dhe përshkueshmëri

(0.05-3.5)mDarsi. Gëlqerorët kanë përcjellshmëri hidraulike $8.6.10^{-10}$ deri në $8.5.10^{-8}$m/s, si dhe transmetueshmëri $8.6.10^{-7}$ deri në $8.5.10^{-5}m^2/s$. Sipas të dhënave sizmike, struktura e Ishmit ka gjerësi rreth 4 km, sipas izobatit 3600m. Rreth kësaj madhësie janë edhe gjerësitë e strukturës së Kozanit dhe të Galigatit. Për këtë arsye, gjerësia 4 km është pranuar për të karakterizuar rezervuarin në rajonin Tiranë-Elbasan. Kjo madhësi është pranuar edhe për ekstrapolinim e gjerësisë së rezervuarit drejt jugut, deri në kufirin shqiptaro-grek. Pusi Ishmi-1/b ka përshkuar një prerje karbonatike me trashësi 1016m. Të dhënat sizmike dhe ato gjeologjike krahinore tregojnë se gelqëroret shtrihen në thellësi të mëdha. Sipas rënies ata vazhdojne rreth 15km. Për siguri të llogaritjes së burimeve të energjisë gjeotermale, trashësia e rezervuarit është marrë 2000m. Kufiri perëndimor i rezervuarit është përcaktuar sipas tektonikës shkëputëse të buzës perëndimore të zonës tektonike Kruja. Kufiri lindor, në plan horizontal është hequr 4km në lindje të kufirit perëndimor.

Siç u tregua më lart, temperatura e ujit në sipërfaqe në rajonin Tiranë-Elbasan, luhatet nga 60°C deri në 65.5°C. Temperatura e ujit në trungun e pusit Kozan-8, në thellësinë e tavanit të rezervuarit ujëmbajtës është matur 80°C. Sipas termogramave në puset Ishmi-1/b dhe Galigati-2, të kryer para fontanimit të ujit, temperatura e prerjes karbonatike ka qënë, përkatësisht, 42.2°C dhe 52.8°C në fundet e puseve. Kjo diferencë e temperaturave të ujit dhe e gëlqerorëve tregon se në kolektorin e rezervuarit ka një përzierje ujërash, me temperaturën përkatëse të thellësisë ku ndodhet rezervuari me ujin termal që vjen nga thellësi të mëdha. Heterogjeniteti i prerjes kolektore bën që uji i nxehtë të qarkullojë nëpër të çarat. Prandaj në prerje ekzistojnë intervale me temperaturë më të madhe ose më të vogël, se sa u tregua më lart.

Burimet e Llixhave të Elbasanit dhe puset Ishmi-1/b e Kozani-8 kanë prurje konstante për periudha të gjata, nga 3.5 deri në 15 l/sec respektivisht mbi 50 vjet, 32 vjet dhe 10 vjet (Pasqyra 7). E stabilizuar është edhe temperatura e ujit. Këto fakte dëshmojnë për regjim termo-hidrodinamik të qëndrueshëm të rezervuarit.

Përllogaritjet e rezervave të energjisë gjeotermale për zonën Tiranë-Elbasan treguan se nxehtësia në vend ka madhësi ($5.87.10^{9}$-$5.08.10^{10}$)GJ, resurset e energjisë gjeotermale ($5.87.10^{8}$-$5.08.10^{9}$)GJ, ndërsa rezervat specifike janë (38.5-39.63)GJ/m^2. Kjo është edhe pjesa më e pasur me rezerva gjeotermale të njohura deri tani e zonës gjeotermale Kruja.

Llixhat në Elbasan kanë fuqinë e mundshme për t'u instaluar 2760 kW, më të madhe se burimet e tjerë. Pusi gjeotermal Kozani-8 ka fuqi të mundshme për tu instaluar 2070kW dhe faktor kapacitiv 1.93MWt. Pusi Ishmi-1/b, ka fuqi të mundshme për t'u instaluar 644kW.

Në sektorin e Galigatit, rezervat specifike janë më të vogla, 0.63GJ/m^2, ndërsa resurset e energjisë gjeotermale $6.5.10^{8}$GJ.

Meqenëse për zonën nga Galigati deri në kufirin shqiptaro-grek, në juglindje të Shqipërisë, nuk ka studime sizmike dhe puse të shpuar në fushën gjeotermale, rezervat specifike të energjisë gjeotermale të Galigatit janë ekstrapoluar për gjithë këtë zonë, deri në Sarandaporo.

Në Zonën Gjeotermale Kruja, mbështetur në qëndrueshmërinë dhjetëravjeçare të prurjeve të burimeve, mund të pritet që puset Ishmi dhe Kozani, me remont dhe me pajisjen e tyre të përshtatshme, të fontanojnë ujë me prurje dhe temperatura më të larta. Kolektori heterogjen i rezervuarit, si edhe regjimi termo-hidrodinamik i qëndrueshëm, lejon të prognozohet, që në zonën gjeotermale Kruja, mund të gjenden burime të reja me rezerva gjeotermale më të mëdha. Për këtë duhet të kryhen kërkime hidrogjeologjike e gjeofizike të detajuara. Në Llixhat e Elbasanit duhet të shpohen puse, që uji të kaptohet në thellësi më të mëdha, ku temperatura është më e lartë.

4.2.3.2. Zona Gjeotermale Ardenica

Në zonën gjeotermale Ardenica, ranorët e akuiferit gjeotermal janë masive deri në shtresë hollë (Fleta 25). Granulometria e tyre është me kokrriza të imëta, mesatare deri në të trasha. Ata kanë porozitet efektiv rreth 0.155 dhe përshkueshmëri të rendit 283mDarsi. Përçueshmëria hidraulike është 4.98m.sek^{-1} dhe transmetueshmëria 8.9. 10-5m^{2}sec^{-1}. Këto veti të mira të kolektorit të rezervuarit kanë çuar në prurje të mëdha , nga (5-18) l/sek.

Rezervuari i Ardenicës ka nxehtësi në vend $8.19{\cdot}10^{8}$ GJ dhe resurse të energjisë gjeotermale $8.19{\cdot}10^{6}$ GJ. Rezervat e provuara janë $1.30{\cdot}10^{5}$ GJ dhe rezervat specifike më të vogla se 0.39·GJ/m^{2}. Sektorët midis strukturave antiklinale janë vlerësuar me rezerva specifike më të vogla se 0.39GJ/m^{2}. Të gjitha puset e treguar më lart, tashmë janë të likuiduar. Zona Gjeotermale Ardenica, aktualisht është vetëm një zonë gjeotermale potenciale. Për të shfrytëzuar energjinë gjeotermale duhet bërë remonti i puseve që kanë fontanuar ujë të nxehtë, nëse është teknikisht e mundshme. Krahas kësaj, të vlerësohen puse të tjerë që janë në gjendje teknike të mirë për marrjen e ujërave termale, pa përjashtuar mundësinë e shpimit të puseve të thellë të rinj, për kushte ekonomike të leverdishme.

4.2.3.3. Zona Gjeotermale Peshkopia

Temperatura e ujit, prurja e madhe, qëndrueshmëria e këtyre dy parametrave, si dhe temperatura e akuiferit të zonës gjeotermale të Peshkopisë janë të ngjashme me ato të Zonës Gjeotermale Kruja. Për këto arsye resurset e energjisë gjeotermale për zonën Peshkopia vlerësohen si ato të zonës Tiranë-Elbasan. Burimet termale të Peshkopisë kanë fuqi të mundshme për tu instaluar të barabartë me 1610 kW.

* * *

Për katër burimet më të mëdha: Llixhat e Elbasanit, të Peshkopisë, të pusit Kozani-8 dhe Ishmi-1/b rezulton se prurja e përgjithshme e ujit termal është 44.8l/sek. Kapaciteti i energjisë gjeotermale 6.64MWt dhe fuqia e mundshme për tu instaluar 7084kW. Por, aktualisht, fluksi i ujit gjeotermal që përdoret është vetëm 10.0 l/sek, përdorimi i energjisë 49.12TJ/vit dhe faktori kapacitiv 0.38MWt.

Këto shifra tregojnë jo vetëm për shfrytëzim shumë të vogël të energjisë gjeotermale, por edhe për përdorim joefektiv. Uji i pusit Kozani-8 me temperaturë 65.5^{o}C, prurje 10.3 l/sek, derdhet në përrua për shumë vite. Për rendiment 60%, energjia e humbur vlerësohet në 253 milionë kWh, afërsisht 20 milionë USD.

III. SHFRYTËZIMI I ENERGJISË GJEOTERMALE

5. DREJTIMET E SHFRYTËZIMI KOMPLEKS DHE KASKADE TË ENERGJISË GJEOTERMALE NË SHQIPËRI

Shqipëria përfaqëson një vend me potencial real të energjisë gjeotermale të entalpisë së ulët, që mund të shfrytëzohet për qëllime ekonomike. Shfrytëzimi i ujërave termale të burimeve ose të puseve lehtësohet nga fakti se ato përgjithësisht ndodhen në zona të zhvilluara nga ana urbane [Frashëri A. dhe Bakalli F. 1995, 1996, 1997, 1998, Frashëri A. 1998, 1999, 2000, 2001, 2002, Frashëri A etj. 2003]

Situata gjeotermale në Shqipëri ofron tre drejtime të shfrytëzimit të energjisë gjeotermale, që aktualisht janë pothuajse të pa lëvruara.

5.1. Ngrohja e godinave publike dhe shtëpive të banimit me anën e nxehtësisë së shtresave pranësipërfaqësore të tokës

Rëndom, kur bëhet fjalë për energjinë gjeotermale, njerëzit mendojnë vetëm ujërat e ngrohta të burimeve. Kjo është një pjesë e të vërtetës. Por, këto ujëra janë zakonisht të rralla dhe të pakta. Ajo që gjendet kudo dhe me sasi të mëdha është nxehtësia e shtresave të tokës. Prandaj edhe drejtimi kryesor i përdorimit të energjisë gjeotermale është shfrytëzimi i nxehtësisë së shtresave pranësipërfaqësore të Tokës për të ngrohur dhe freskuar banesat private dhe godinat publike, duke përdorur sistemet moderne këmbyes nxehtësie-pus-pompë gjeotermale nxehtësie (Fleta 27-a).

Nxehtësia nxirret me një këmbyes vertikal të nxehtësisë, i cili futet në një pus të cekët (100-150)m të thellë). Ky këmbyes është i ndërtuar nga një tub në formë U-je, ose nga dy tuba bashkëksial. Uji i pompuar ngrohet duke u futur në thellësi dhe rikthehet në sipërfaqen e tokës me temperaturë më të lartë. Për godina shumë të mëdha nevojitet sistem pusesh.

Sot në botë ka mbi 570000 instalime të tilla për ngrohjen e shtëpive private të banimit por edhe godinave me sipërfaqe deri në 160000 m^2, duke kursyer deri në tre herë energjinë.

Në Svicër ka mbi 21000 instalime të tilla, nga të cilat prodhohen 365 milion kilovat-orë në vit.

Sistemet Këmbyes Nxehtësie-Pus (KNP)-Pompë Gjeotermale Nxehtësie (PGjN) për ngrohjen e banesave janë sistemet më moderne, me teknologji më të përparuar, miqësore me mjedisin dhe po bëhen gjithënjë e më shumë popullore.

Në shumë vende të Komunitetit Europian bëhen përpjekje të mëdha për të reduktuar përdorimin e karburantit për ngrohje dhe për të kursyer energjinë elektrike. Burimet vendore të energjisë, siç është nxehtësia e shtresave pranësipërfaqësore janë veçanërisht në fokus, edhe për përparësitë e tyre për mbrojtjen e mjedisit, që lidhen me efektin serë [Chuanshan D etj. 1995, Clauser Ch. 1997, Hofman F etj. 1993, Lund J.W. 1996, Rybach L etj. 2000].

Kriza energjetike e vendit, po shoqërohet edhe me kërkesën gjithnjë e në rritje të sasisë së energjisë për ngrohjen dhe freskimin e banesave, çka e bën edhe më aktuale përdorimin e energjisë gjeotermale (Fleta 27-b).

Ashtu si kudo, edhe në Shqipëri, shtresat pranësipërfaqesore të Tokës kanë nxehtësi. Temperatura e këtyre shtresave përcaktohet nga dendësia e fluksit termik, relievi i zonës, pozicioni gjeografik i saj, përbërja litologjike e depozitimeve të shkrifta dhe shtresave të shkëmbinjve rrënjësorë në këto thellësi, si edhe nga kushtet klimatike.

Nga të dhënat e hartës së temperaturës në thellësinë 100m për të gjithe territorin shqiptar (Fleta 7) rezulton se temperatura në këto thellësi luhatet prej 6.7 deri në 18.8^{o}C në krahinat e ndryshme të vendit (Pasqyra 7):

TEMPERATURA NË THELLËSINË 100m SIPAS KRAHINAVE TË SHQIPËRISË

Pasqyra 7

Krahina	Temperatura minimale, në **^{o}C**	Temperatura maksimale, në **^{o}C**	Temperatura mesatare, në **^{o}C**
Bregdetare	16.60	18.80	17.80
Fushore perëndimore	17.15	18.41	18.0
Kodrinore- malore	6.70	18.60	14.75

Shtresat që shtrihen në thellësitë nga (0-8-10)m kanë temperaturë që kushtëzohet nga fluksi i nxehtësisë së rrezatimit diellor. Në dimër, temperatura e tyre është më e vogël sesa në periudhen e verës. Nën këto thellësi, temperaturat e shtresave nuk varen më nga rrezatimi diellor. Por jo kudo janë këto limite të thellësisë së ndikimit të rrezatimit diellor. Në varësi të litologjisë së shtresave dhe të klimës, thellësia e ndikimit të rrezatimit diellor është e ndryshme.

Në fleten 8-a paraqitet termograma e një pusi në Rinas-Tiranë, ku duket se gjatë verës ndikimi i rrezatimit diellor arrin deri në 20m. Nën këtë thellësi, temperatura mbetet e pandryshuar në stinë të ndryshme.

Nga analiza e mësipërme rezulton se gjendja e regjimit gjeotermal të prerjes pranësipërfaqësore është e niveleve të tilla që lejon të shfrytëzohet nxehtësia e tyre për të ngrohur ose freskuar zyra, spitale, biblioteka, shkolla, teatro e kinema, godina aeroporti, si edhe blloqe banesash e vila për banim duke përdorur sistemet moderne këmbyes nxehtësie pus-pompë gjeotermale nxehtësie [Frashëri A. etj., 2003].

Nxehtësia e këtyre shtresave ka shkaktuar edhe ngrohjen e ujërave të truallit në rezervuarin nëntokësor. Në pasqyrën 8 (faqe 84), paraqiten të dhëna për puse në qytetin e Tiranës. Krahas temperaturës tregohen edhe karakteristika të tjera, si litologjia e rezervuarit ujëmbajtës, debiti, thellësia e vendosjes se pompës, lartësia e ngritjes së ujit dhe fuqia e elektropompës zhytëse të montuar në puset. Nga të dhënat e kësaj pasqyre duket së uji i pellgut të ujërave nëntokësore të qytetit të Tiranës, pasi është i ngrohur nga nxehtësia shtresave të tokës, mund të shërbejë si burim për pompat gjeotermale të nxehtësisë. Nga ky basen mund të merren sasi uji të duhura për të realizuar furnizimin me ujë të pompës gjeotermale të nxehtësisë në shumë lagje të qytetit.

Furnizimi me ujë i pompës gjeotermale të nxehtësisë realizohet nëpërmjet një pusi të cekët (100-150m të thellë) të shpuar për këtë qëllim në oborrin e godinës. Për godina shumë të mëdha nevojitet sistem pusesh. Në mënyrë që elektropompa zhytëse të punojë normalisht duhet të zhytet më thellë se 1.5m nën nivelin dinamik të ujit në pus. Sa më thellë të zhytet pompa aq më pak probleme do të ketë gjatë shfrytëzimit dhe uji do të jetë me temperaturë më konstante. Uji i nxjerrë nga elektropompa zhytëse, nëpërmjet linjës së ushqimit dërgohet në impiantin e pompës gjeotermale të nxehtësisë. Mbas daljes së ujit nga pompa e nxehtësisë, ai injektohet në shtesën ujëmbajtëse nëpërmjet një pusi tjetër. Me këtë injektim stabilizohet ekuilibri në shtresën ujëmbajtëse, si edhe niveli statik dhe ai dinamik i ujit në pusin e marrjes.

Sistemi KN-P-PGjN ka marrë zhvillim të madh në vendet e përparuara, për ngrohjen dhe freskimin e godinave megjithëse ka kosto ndërtimi (30-40)% më të lartë se sa kostua e sistemeve ngrohëse konvencionale, me kaldajë nafte.

Ka disa arsye për këtë:

1. **Konsiderata ekonomike**. Kostua vjetore e “karburantit” të sistemit KN-P-PGjN (energjia elektrike për pompën e nxehtësisë dhe pompën e qarkullimit) është në mënyrë të konsiderueshme më të ulët se karburanti i një ngrohësi konvencional me naftë ose gaz. Për koeficient performance KSP = 3, kursehet deri në 66% e energjisë elektrike. Kështu, koha e kthimit të shpenzimeve të KNP është më e shkurtër se koha e punës së vetë sistemit ngrohës.
2. **Konsiderata mjedisore**. KNP-pompë nxehtësie është një sistem mjedisor i pastër që nuk emeton gaze CO_2, që shkaktojnë “efektin serë”, kështu që do të evitohet për pronarin e shtëpisë pagesa e taksës për emisionin e gazeve CO_2, e cila është në diskutim në vendet e Komunitetit Europian.
3. **Mbështetje qeveritare**. Për instalimin e sistemit KN-P-PGjN, qeveritë e vendeve te ndryshme japin investime për çdo kWe të pompës gjeotermale të nxehtësisë.

5.2. Përdorimi kompleks dhe kaskadë i energjisë së ujërave gjeotermale

Përdorimi klasik i ujërave termale në të kaluarën ka qenë i kufizuar. Ato shfrytëzohen vetëm për kurimin e sëmundjeve të ndryshme në qendra balneologjike, të ashtuquajturat “llixha” (Fleta 28, 29).

Por, në çerek shekullin e fundit u bë një ndryshim në koncept. Sot, ujërat termale konsiderohen se janë të dobishme për tu përdorur gjerësisht për ripërtritjen e shëndetit të njerëzve të shëndetshëm dhe për dëfrimin e tyre, që janë edhe shumica e popullsisë, krahas klinikave për kurimin e sëmundjeve. Prandaj ndërtohen edhe hotele, madje organizohen fshatra turistike, me pishina dhe banja me ujë të ngrohtë, [Arpasi S dhe Szabo G. 1999, Bojadgieva K etj., 1999, Kowski W. 2000, Krajl P. 1999, Fumadzieva S. etj., 1999]. Në qendrat gjeotermale të Italisë, bëhen rreth një milion ditë vizita në vit nga turistët.

Zona gjeotermale Ishëm-Elbasan ndodhet pranë aeroportit “Nënë Tereza” të Tiranës, qytetit historik të Krujës dhe plazheve të Adriatikut, liqenit të Ohrit, perlës së Ballkanit dhe qendrës klimatike malore në pyjet e famshëm të Gjinarit në jug-lindje të Elbasanit. Burimet e Llixhave të Elbasanit, pusi gjeotermal Kozani-8, që ndodhet pranë manastirit Shën Gjon Vladimirit në Shijon të Elbasanit, dhe pusi Ishmi-1/b kanë mundësi për zhvillim me teknologji moderne, duke u kthyer në qendra turistike rigjenerimi dhe pushimi, krahas veprimtarisë mjekësore kurative. Burimet e Urës së Katiut në Bënjë të Përmetit, burimi i avullit në Postenan dhe burimi i Sarandaporos, krahas veprimtarisë mjekësore, kanë gjithashtu mundësi të mëdha për t'u kthyer në qendra turistike shumë tërheqëse, në kushtet edhe të natyrës jashtëzakonisht të bukur të trevës dhe të popullit mikpritës, në fshatrat që mund të kthehen në pritëse të turistave. Fshatrat Bënja në Përmet, Postenani në Leksovik, Shijoni në Elbasan etj. pranë burimeve e puseve termale, mund të kthehen në fshatra turistike shumë të bukur. Qendra Balneologjike e Peshkopisë, me vlerat e saj të mira kurative, me ndërtimin si dhe me pishinën me ujë termal, e ndodhur pranë liqeneve piktoreskë të Lurës dhe në këmbë të Korabit, malit më të lartë të vendit dhe me bjeshkët shumë të bukura, i ka kapacitetet energjetike dhe vlerat estetike të mjedisit e të natyrës për t'u kthyer në qendër kurative dhe turistike e rëndësishme jo vetëm për Shqipërinë veri-lindore.

Përparimi më i madh teknologjik i shfrytëzimit të energjisë së ujërave termale është përdorimi në mënyrë kaskadë për shumë procese, nga temperaturat më të larta, derisa uji merr temperaturën e mjedisit. Kjo është mënyra më kursimtare e shfrytëzimit të kësaj energjie alternative [Frashëri A. etj., 2003]. Për të realizuar përdorimin kaskadë për një varg sa më të gjatë veprimtarisht, në çdo stinë, shfrytëzimi i energjisë gjeotermale bëhet në kombinim me energjinë diellore dhe energjinë e erës. Në këtë skemë përfshihen edhe koncepti i shfrytëzimit kompleks, sepse përdoren teknologjitë moderne si pompat gjeotermale të nxehtësisë dhe panelet diellore.

Ngrohja e fshatrave, e hoteleve turistike dhe e pishinave të tyre, e klinikave, ngrohja e serave për prodhimin e luleve dhe perimeve janë nga drejtimet e rëndësishme të përdorimit të energjisë së ujërave gjeotermale në këtë kaskadë, që duhet të zbatojnë edhe të gjitha qendrat ekzistuese balneologjike në vendin tonë.

Pasi është shfrytëzuar në nyjet e mësipërme, uji përdoret për zhvillimin e akuakulturës, sipas dy drejtimeve:

- Rritjen e rasateve të peshqve etj.
- Kultivimin e algave, me të cilat prodhohen pomada nga më efektivet për shumë sëmundje të lëkurës dhe kremra për kozmetikë.

Procesi i fundit në këtë kaskadë është nxjerrja e mikroelementeve dhe kripërave natyrore nga ujërat termale minerale. Gjatë proceseve të ndryshme të kaskadës, nxirren edhe gazet e lirë CO_2 dhe H_2S, që përdoren përkatësisht për konservimin e produkteve ushqimore dhe për procedura të posaçme mjekimi të rrugëve të frymëmarrjes.

Vetëm pas kësaj, uji mund të përdoret për ujitje, ose të injektohet në rezervuarin gjeotermal.

Ujërat e pijshëm minerale mund të industrializohen për tu përdorur nga popullsia. Edhe në Shqipëri ka ujëra të tillë, si ato të Bënjës në Përmet, të Sarandaporos në Leskovik, të Ardenicës etj.

5.3. Ngrohja dhe freskimi i serave

Energjia gjeotermale e shtresave në thellësi të Tokës, si edhe uji i nxehtë që përmbajnë rezervuarët gjeotermale po përdoren gjithnjë e më tepër edhe për ngrohjen e serave për prodhimin e perimeve dhe luleve, si edhe për tharjen e frutave dhe perimeve. Janë të famshme serat në Lardarelo të Italisë, ku prodhohen lule ekzotike dhome. Sipërfaqet e serave të ngrohura me energjinë gjeotermale janë një investim me përfitime të mëdha, prandaj ato po shtohen nga viti në vit në vende të ndryshme të botës. Në shtetet përreth Shqipërisë, aktualisht funksionojnë mjaft sera, si: në Greqi (34ha), Bullgari (22 ha), Maqedoni (62.4ha), Serbi (10.13ha), Kroaci (0.25ha) [Andrejevski B dhe Armanski S. 1999, Campioti C. etj. 1999, Koreneos C.J. etj., 1999, Bojadgieva K. etj., 1999, Kralj P. 1999, Arpasi M. etj., 1999, Popovski K. 2003, Popovska S etj., 1999, 2003, Rafferty K dhe Boyd D., 1997]:.

Në vitet e fundit në Itali, në veri të Romës, janë ndërtuar një seri serash demonstrative moderne me përmasa (8x30x3.70)m dhe (24x20x3.40)m, të cilat ngrohen me energjinë e ujit gjeotermal me temperaturë 40°C dhe prurje 10 l/sek.

Energjia gjeotermale për ngrohjen e serave përftohet në dy rrugë:

1. Nga ujërat gjeotermalë që fontanojnë nga puse të thellë ose nga burimet natyrore,
2. Duke përdorur sisteme moderne Këmbyes Nxehtësie Vertikal në puse të thellë, duke i kthyer ato në Burime Vertikale Nxehtësie [Clauser Ch. 1997, Chuanshan D etj., 1995, Lund J.W. 1996].

Në Ultësirën Prandariatike, si edhe në Zonën Jonike, në një territor të gjerë nga Durrësi e deri në Vurg, nga Semani e deri në Kuçovë ka puse që kanë fontanuar ujë gjeotermal, të cilët mund të riaktivizohen për të marrë përsëri ujë të nxehtë. Ka edhe qindra puse të thellë të naftës e të gazit të braktisur, të cilët mund të ketë shtresa kolektore me ujë me temperaturë të lartë, që mund të shërbejnë edhe si burime vertikale nxehtësie. Në kompleks edhe me pompat e nxehtësisë, uji i këtyre puseve mund të shërbejë për ngrohjen e serave [Frashëri A. etj., 2003].

* * *

Burimet e energjisë gjeotermale të entalpisë së ulët në Shqipëri, disa prej të cilëve janë njëkohësisht edhe burime ujërash shumë elementëshe, përbëjnë bazën për përdorim të suksesshëm të teknologjive moderne për përdorim *kompleks dhe kaskadë të kësaj energjie*, miqësore me mjedisin, duke patur efektivitet ekonomik të mirë. Zhvillime të tilla janë të dobishme edhe për krijimin e vendeve të reja të punës dhe përmirësimin e jetës së komuniteve lokalë pranë këtyre burimeve termale.

6. IMPAKTI MJEDISOR NGA SHFRYTEZIMI I UJERAVE TERMALE

Shfrytëzimi i ujërave termale lidhet edhe me problemet e mbrojtjes dhe të ruajtjes së mjedisit. Sot, ujërat termale që burojnë në vendin tonë derdhen në natyrë, në sipërfaqen e tokës dhe në përrenjtë përreth burimeve (Fleta 30). Në zonën e Elbasanit, ujërat termale përmbajnë rreth 6.8 g/l mbeturina të ngurta. Në sasi të mëdha janë kationet e Na^+ 1.19 g/l, Ca^{2+} 0.79 g/l, Mg^{2+} 0.20 g/l, K^+ 0.17 g/l, NH_4^+ 0.02 g/l, gjurmë kationesh Fe, Cu, Al, si edhe anione Cl^- 2.36 g/l, SO_4^{2-} 1.78 g/l, HCO_3^- 0.43 g/l etj. Ato përmbajnë edhe gazra H_2S në total 6.8 g/l, CO_2 të lirë 0.16g/l etj.

Ujërat termale që derdhen në natyrë kanë impakt negativ mbi mjedisin [Frasheri A. etj., 2003, Popovska Vasilevska S. 1999]:

- Ndotja e ujërave sipërfaqësore, që përdoren për ujitje etj. Përdorimi këtyre ujërave të ndotura me elemente kimike dhe kripëra të ndryshme për ujitje sjell edhe ndotjen dhe pasurimin e tokës bujqësore me kripëra të ndryshme, në mënyrë të veçantë me kripëra të klorurit të natriumit, të sulfateve dhe të karbonateve të kalciumit dhe magneziumit.
- Ndotja e ujërave të truallit, që përdoren si ujë i pijshëm, industrial etj., me kripërat e treguara më lart.
- Ndotja e ajrit me gazin sulfhidrik dhe karbonik, duke i dhënë aromën e pakëndshme të vezës së prishur.
- Varfërim të biodiversitetit.

Prandaj është e domosdoshme që këto ujëra të pastrohen përpara se të dërgohen në sistemin e drenimit dhe në përrenj e lumenj, ose të ri injektohen në nëntokë në rezervuarët gjeotermalë.

ATLAS
OF GEOTHERMAL RESOURCES
IN ALBANIA

Extended Summary

TABLE OF CONTENTS

(Extended English Summary)

Plate 4-b. Geological-geophysical Shkodër-Kukës profile.1. Effusive rocks; 2- Ultrabasic rocks; 3- Gabbro; 4- Sedimentary formation;5- Disjunctive tectonic.

Plate 5. Reflection seismic line in Ionian and Peri-Adriatic Depression. [Frasheri A., Bushati S., Bare V.,2003].

Plate 6. Map of Wells & Boreholes with Temperature Logging.

Plate 7. Temperature Map at the depth 100 m.

Plate 8-a. Thermolog of Rinasi-1 borehole.

Plate 8-b. Termolog of the Ohrit Lake, Piskupat zone.

Plate 8-c. Termolog of the Ohrit Lake, Guri Kuq zone.

Plate 9. Temperature Map at the depth 500 m.

Plate 10. Temperature Map at the depth 1000 m.

Plate 11. Temperature Map at the depth 2000 m.

Plate 12. Temperature Map at the depth 3000 m.

Plate 13. Average Geothermal Gradient Map.

Plate 14-a. Geothermal Profile Divjakë.

Plate 14-b. Geothermal Profile Kolonjë.

Plate 14-c. Geothermal Profile Ballsh.

Plate 15-a. Geothermal Profile Papër.Legend: See Plate 14.

Plate 15-b. Geothermal Profile Kalcat.Legend: See Plate 14.

Plate 15-c. Geothermal Column Povelça.

Plate 15-d. Overnormal pressure influence on temperature field. (Liço R. et al. 1998). 1. Temperature, ^{o}C; 2- Resistivity, $x10^{-1}$ Ohmm; 3- Pressure, Mpa; 3- Change of the well diameter, in %; TM- Top of the overnormal pressure zone.

Plate 16. Heat Flow Density Map.

Plate 17. Geothermal Thematic Map.

Plate 18. Geothermal Springs and Earthquakes Epicentres Map. [Sejsmological data after Sulstarova E. at al. 1972].

Plate 19. Geothermal Springs and Earthquake Isoseistes Map. [Sejsmological data after Sulstarova E. at al. 1972].

Plate 20. Kruja Geothermal Zone Map (Northern part).

Plate 21-a. Photo: Geothermal Well Ishmi 1/b.

Plate 21-b. *Photo: Geothermal Well Kozani-8.* (Foto Arjan Gaçe)

Plate 22-a. *Topographic Sketch, Water place of Llixha Elbasani. (Avgustinsky V.L. 1957)* 1- Calcolistoth; 2- Shale; 3- Conglomerate; 4 Kaolinized rocks; 5- Thermal sorce.

Plate 22-b. Photo: Llixha Elbasani Geothermal Area.

Plate 23-a. Tectonic Map, Geothermal Sources field Bënjë-Postenan-Sarandaporo. **[The Tectonic Map of Albania, Scale 1:200 000, 1985].** 1- Quaternary deposits (Q_1 - Q_3); 2- Oligocene flysch deposists, Burdigalian-Tortonian tectonogenesis; 3- Oligocene flysch deposists, Late Middle Oligocene tectonogenesis; 4- Eocene neritic limestones; 5- Flysch deposists, Late Eocene tectonogenesis; 6- Lower Cretaceous limestone, Late Cretaceous tectonogenesis; 7- Upper Triassic-Lower Jurassic undifferentiaded carbonate deposists, Late Jurassic tectonogenesis; 8- Serpentinite; 9- Nappe boundary; 10- Synclinal axis; 11- Anticlinal axis; 12- Thermal water springs; 13- Steam springs.

Plate 23-b. Photo: Geothermal Springs Bënjë, Langarica River, Përmet.

Plate 24-a. Photo: Tectonic Fault at Steam Springs Area, Postenani Mountain, Leskovik.

Plate 24-b. Photo: Steam Discharge Tectonic Fault, Postenan.

Plate 24-c: Photo: Geothermal Springs Area, Sarandaporo, Leskovik.

Plate 25. Ardenica Geothermal Zone Map.1 .Hot water inflow; 2- Geological age boundary; 3- Seismic boundary; 4 -Disjunctive tectonics; 5-Unconformity surface; 6- Neogene Molasse (N_1^3- N_2); 7- Burdigalian Marlstone (N_1^b) – Aquitanian Flyschoid (N_1^a); 8- Oligocene Flysch (Pg_3) ; 9- Upper Cretaceous-Eocene Limestone (Cr_2-Pg_{12}).

Plate 26-a. *Geological Map, Peshkopia Geothermal Zone.* [After Tectonic Map of Albania, scale 1:200 000, 1985]. 1 -Ordovician-Devonian metamorphosed terrigenous sediments with volcanic intercalations;2- Evaporite deposits (T); 3- Late Jurassic tectogenesis formation: Carbonate (T_1 and T_2-J) and Conglomerate of Verucano Serie (P-T_1) ; 4- Volcanosedimentary formation (T_{1-2}); 5- Early Flysch (J1-$Cr2^{cen}$); 6- Upper Eocene - Lower Oligocene (Pg_2^3-Pg_3^1) Flysch; 7- Late Pliocene-Quaternary sandstone-conglomerate-marls etc. Deposits; 8- Thermal water springs;9- Boundaries of salt domal structures (evaporites).

Plate 26-b. Photo: Peshkopia Geothermal Zone, Banja Torrent, Peshkopi.

Plate 27-a. Space heating Borehole Vertical Heat Exchanger-Geothermal Heat Pump System.

Plate 27-b. Annual Electric Power with and without heating, 1999. (National Agency of Energy].

Plate 28. Photo: Balneological Centres Park and Hydrat Hotels-Elbasan, Peshkopi, and Sarandaporo (in reconstruction).

Plate 29. Photo: Balneological Centres: Hydrat Hotel-Elbasan, and Sarandaporo SPA (in reconstruction).

Plate 30. Photo: Environmental impact from thermal water discharge, Llixha Elbasan [a], and Kozani-8 well (b).

ATLAS OF GEOTHERMAL RESOURCES IN ALBANIA

Introduction

The Monograph “ATLAS OF GEOTHERMAL RESOURCES IN ALBANIA” is published in the framework of the National Program for Research and Developing- Natural Resources, 2003-2005. This Atlas represents the publication of the results of studies which were performed in the framework of the Committee for Sciences and Technology of Albania Projects and agreement between the Faculty of Geology and Mining, and the Geophysical Institute, Czech Acad. Sci., Prague, European Commision-International Heat Flow Commission and UNDP-GEF/SGP Tirana Office projects [1, 2, 3, 4, 5, 6].

Studies- Atlases [2, 3, 4], are the results of the intensive work carried out by a joint team of the Geophysical Section of the Faculty of Geology and Mining of the Polytechnic University of Tirana, the Department of Geothermics of Geophysical Institute of Czech Republic, Prague, and of the Oil and Gas Geological Institute, Fier Albania. The joint team of Albanian and Czech researchers and professionals comprised of geophysicists and geothermists, geologists, hydrogeologists, physicists and geodesists.

Preparation for the monograph publication is realized by a scientific team: Prof. Dr. Alfred Frashëri (Editor- in- Chief), Prof. Dr. Rushan Liço, Dr. Fiqiri Bakalli, Prof. Dr. Neki Frashëri, Prof. Dr. Niko Pano, Prof. Dr. Salvatore Bushati, Prof. Dr. Bashkim Çela, Prof. Dr. Ëngjëll Prenjasi, Prof. As. Dr. Hajri Haska, Inxh. Burhan Çanga, informatics Dashamir Hoxha.

Th Atlas will create the scientific base for the direct use of geothermal energy in Albania, and presents a modest contribution to the country’s energy balance system.

A cknowledgements

Consultations have been carried out and specific issues have been resolved in cooperation with geothermics team of Budapest Eotvos University, Dr. Luiza Bodri, Study University of Bari Italy, Department of Geology and Geophysics, Prof. Francesco Mongelli and Prof. Gianmaria Zito as well as with Prof. Michael Fytikas from Aristotle University of Thessaloniki. We greatly appreciate their contribution. Geothermal studies and projects are performed by scientific collaboration with Institute of Informatics and Applied Mathematics (INIMA) Tirana. We are grateful to Prof. Dr. Acad. Gudar Beqiraj and Prof. Dr. Neki Frashëri for very good collaboration, contribution and help. Also we express our thanks to Prof. Dr. Geys Mebu A. Niedersachsisches Landesamt Fur Bodenforschung, Hannover, for cayrring out the analyses of tritium and Oxygen 18, and Dr. Jovan Zoto, Institute of Nuclear Physics of Albanian Academy of Sciences for Oxygen 18 analysis.

We express our gratitude to the editors Dr. E. Hurtig, Dr. Vladimir Çermak, Dr. Ralf Haenel. and Dr. Vladimir Zui of the GEOTHERMAL ATLAS OF EUROPE, 1992, as well as editors Dr. Suzanne Hurter and Dr. Ralph Haenel of the ATLAS OF GEOTHERMAL RESOUCES IN EUROPE for their supervision during preparation of the Atlases. We would like also to thanks Dr. Andrew Green, CSMA Ltd., coordinator of the ATLAS OF GEOTHERMAL RESOUCES IN EUROPE and B.Sc. DMS Hydn Scholes, CSMA Ltd., for their continuous support and consideration towards our work during the presentation of the Atlas.

We express our gratitude to Arjan Gaçe, of the UNDP-GEF Tirana Office, Prof. Dr. Kiril Popovski, St. Kliment Ohridski University, Bitola and Prof. John V. Lund, Oregon Institute of Technology for their contribution and help to our study and investigations for the directions of the use of environmentaly friendly geothermal energy in Albania.

Cordial thanks to Mr. Andrew M^{c}Leish for the correction of the English Summary of the Atlas.

We are grateful to Project Department in the Committee for Science and Technology of Republic of Albania, the Deanship of the Faculty of Geology and Mining of the Polytechnic University of Tirana, the Directory of Geophysical Institute of Academy of Sciences Czech Republic, Prague, the Directory of Institute of Informatics and Applied mathematiks (INIMA) Tirana, the Directory of Oil and Gas Geological Institute, Fier Albania, the Directory of Leibniz Institute for Applied Geosciences (GGA), Hannover, Germany, and to the UNDP-GEF Tirana Office for their continuous support and help for the realization of the geothermal projects,

We are thankful to the Ministry of Education and Sciences of Republic of Albania, Chairmanship of the Academy of Sciences of Republic of Albania, and the Deanship of the Faculty of Geology and Mining in Polytechnic University of Tirana, for their understanding and creating of the conditions for publishing of the “Atlas of Geothermal Energy Resources in Albania”.

I. AREA DESCRIPTIONS, METHODS AND MATERIAL STUDIES

1.1. Outlook on Geological setting of Albania

Integrated onshore and offshore regional geophysical studies have been performed for the exploration of the Albanides. Seismological studies, gravity and magnetic surveys, reflection seismic lines, geothermal studies, radiometric investigations, vertical electrical soundings and integrated well loggings represent the applied complex of the geophysical investigation. The structural analysis of the Albanides açording to the seismological studies, reflection seismic, gravity, magnetic, electrical, and geothermal surveys, in the framework of the integrated interpretation with geological studies results are presented.

The Albanides represent the assemblage of the geological structures in the territory of Albania, and together with the Dinarides at the North and the Hellenides at the South, have formed the southern branch of the Mediterranean Alpine Belt (Fig. 1) [Aubouen I. & Ndoja I., 1964, Biçoku T. & Papa A. 1965, Bushati S. 1998, Frashëri et al. 1996, Meço S. & Aliaj Sh. 2000, Melo V. 1986, Papa A. 1993, Prenjasi E. 1999, Tectonic map of Albania 1985, Ricou E.L. et al. 1998]. Two major peleogeographic domains form the Albanides: the Internal Albanides in the eastern part and the External Albanides in the western part of Albania.

The Internal Albanides are characterized by the presence of the immense and intensive tectonised ophiolitic belt, which is displaced from east to west as an overthrust nappe. There are two viewpoints about the tectonic setting of the ophiolites: Allochtone character of the ophiolitic nape [Abouin I. 1973, Cadet J.P. et al. 1980, Frashëri A. et al. 2000, Hoxha L. 2000, Langora et al. 1983] and the autochthon ophiolitic belt [Becaluva L. et al. 1994, Bushati S. 1998, Gjata K. & Kodra A. 2000, Kodra A. 1998, Shallo M. et al. 1989]. The External Albanides were developed beside the western passive margin and continental shelf of the Adriatic plate [Aliaj Sh. 1987, Bare V. et al. 1986, Dalipi H. 1985, Frashëri et al. 1996, Mëhillka L. et al. 1999, Xhufi C. & Canaj B. 1999]. The External Albanides are affected only by the later paleotectonic stages, and are characterized by regular structural belts, which are associated with thrust and over tectonic.

1.1.1. Earth Crust configuration

Seismological studies, regional gravity and magnetic survey data reflect the Earth Crust configuration (Plate 1-a, 2, 3, 4), [Arapi S. 1982, Bushati S. 1982, 1997, 1998, Frashëri A. et al. 1996, Koçiu S. 1989, Lubonja L. et al. 1968, Sulstarova E. 1987, Veizaj V. & Frashëri A. 1986]. The structure of the Earth Crust açording to the refraction seismic data is presented in Plate 1-a. Geophysical data reveal that the Earth crust becomes thicker from the central regions of the Adriatic towards Albanides inland. The sedimentary crust has about 10 km thickness in Adriatic seashore and reaches up to 15 km in northwestern regions of Albania (Plate 1-a, 4-a), [Frashëri A. et al. 1996, Koçiu S. 1989, Veizaj V. & Frashëri A. 1986]. Rocks, with a seismic wave velocity of (5.9-6.2)km/sec, present the lower part of the sedimentary crust. These rocks have a very consolidated structure. In the Albanides are fixed four of third order trends of the Bouguer anomalies: two maximums two minimums (Plate 2). The main gravity maximum is extended on the northeastern part of the Mirdita tectonic zone and on the Korabi one. The second maximum, which is located in the Vlora district, in the southwestern part of Albania, has a sub-transversal strike with geological structures of the Ionian tectonic zone. These regional gravity maximums are attributed to a crust thinning toward the Mirdita tectonic zone and in Vlora district (Plate 1-a, 2). The main gravity minimum is extended from the southeastern region of Albania to the northwestern littoral of Albania. The second minimum is located in the Alps tectonic zone, by a strike in the SE-NW direction. Generally, the Bouguer anomaly increases from the Adriatic Sea Shelf to the Eastern part of the Albanides, (Plate 2, 4-a). The geological-geophysical profile Albanid 1 presents the decreasing of the depth of roof of the Moho discontinuity in Adriatic Sea region (Plate 4-a). The Moho discontinuity plunges from 25 km in the central part of the Adriatic Sea [Finetti, I. and Morelli, C.; 1972] to (43- 52)km at eastern part of Albanides. Regional gravity anomalies are caused by a block construction of the crust, which comes out from the results of seismological studies. This tectonic setting of the deep levels of the earth crust in the Albanides finds its reflection even in the distribution of the magnetic fields (Plate 3). The interpretation of the regional magnetic anomalies shows that the top of the crystal basement plunges toward the littoral of the Albanides up to their central areas (Plate 4-a).

The Earth crust in the Albanides is interrupted by a system of longitudinal fractures in NW-SE direction and transversal fractures that touch the mantel (Plate 4-a). The geothermal energy of the Albanides is linked with these deep fractures.

The tectonic setting of the deep levels of the Albanides Earth Crust and their dynamics has conditioned the geology and tectoniuc style Albanides.

1.1.2. Tectonic Zones

Geological and geophysical regional studies, based on facial-structural criteria, have distinguished the following tectonic zones (Plate 1-b):

A) Internal Albanides: **Korabi, Mirdita, Gashi tectonic zones,**

B) External Albanides **Albanian Alps, Krasta-Cukali, Kruja, Ionian,**

Sazani tectonic zones, and Peri Adriatic Depression.

Intensive Bouguer anomalies and very turbulent magnetic field, with weak anomalies (Plate 2, 3), characterize the ophiolitic belt of the Mirdita tectonic zone in the Internal Albanides. The ophiolitic belt has its biggest thickness about 14 km at its northeastern extreme, in the ultrabasic massif of Kukes. This thickness is reduced up to 2 km towards the west and the southeast (Plate 4-a, 4-b). This interpretation is demonstrated a allochton character of ophiolite belt and the covering character of the western contact of ophiolites with the formation of Krasta-Cukal zone of External Albanides. The relations between the Internal and the External Albanides have a nappe character. The separation of the gravity and the magnetic anomalous belts in the central region of the Internal Albanides, at Shengjergji flysch corridor, arguments the presence of Diber-Elbasan-Vlora transversal fault (Plate 2, 3).

A joint characteristic of structural belt of Ionian and Kruja zones in the External Albanides is their westward thrusting, too. The thrusting process is helped by the presence of the Triassic evaporite sheet under the carbonate section. Açording to the integrated geological-geophysical studies and deep well data results that two tectonic styles are observed in the Ionian tectonic zone: duplex and imbricate tectonic. Traversal faults have separated the Ionian basin in several blocks. Following limestone top of the south Adriatic basin and Sazani, Ionian and Kruja zones are observed that the limestones of the southern Adriatic basin are extended under the last units. Peri-Adriatic Miocene and Pliocene molasses deposits cover partly the Sazani, Ionian and the Kruja tectonic zones. They are placed trangressively over the older section down to the limestone of the Eocene, creating a two-stage tectonic stage (Plate 5). The molasses post-orogenic deposits have covered transgressively Mirdita and partially Krasta–Cukali tectonic zones in Korça and Burreli basins.

Internal Albanides

The tectonic zones of the Internal Albanides extend to the eastern part of Albania.

Korabi zone (K) continues as the Pelagonian zone in Hellenides and as the Golia zone in Dinarides. In the Korabi zone the field of Bouguer anomaly is normal and this reveals that the structures are of low orders (Plate 2). The quiet gravitational zone of Korabi in the west is in contact with the anomalous zone on the ophiolites of Mirdita tectonic zone. The contact between Korabi and Mirdita zone coincides with the deep seismogene structure Ohrid-Qarishtë-Qafë Murrë-Kukës [Sulstarova, E.; 1987]. In this zone outcrops the oldest formations of Albania.

Mirdita zone (M) represents a wide belt along the whole length of the country, from northwest to southeast. The ophiolitic belt is characterized by intensive anomalies of the Bouguer anomaly and by a magnetic field with weak anomalies, which are very turbulent (Plate 1-b, 2, 3, 4).

There are three characteristics of this anomalous belt:

- Firstly, they are divided in two parts, at the north and at the south of Shengjergji flysch's corridor;
- Secondly, there are five gravity maximums, with epicenters set one after the other in an anomalous chain from Tropoja-Kukesi ultrabasic massifs in the northeast part of Albania to the Morava massif, at southeastern area. The anomalies have maximal amplitude up to 105mgal and strong gradients separate them one from the other. The anomalous belt undergoes a powerful turn of 60^o-70^o toward the direction of the Dinarides ophiolitic belt in the northern part of Albania,
- Thirdly, the biggest amplitudes of the anomalies came from the northern part of ultrabasic massifs of the eastern belt. While the southern part of the Albanides ophiolitic belt has a more limited thickness and it keeps developing southwards in Hellenides.

The ophiolite belt has its biggest thickness about 14 km in its northeastern edge, in the Kukesi ultramaphic massif (Plate 4-b). The northwestern sector of the ophiolitic belt is extended in the east of Shkodra town (fig. Plate 4-b). The amplitude of Bouguer anomaly on the Gomsiqe ultrabasic massif is 12mgal. Decreasing of the Bouguer anomaly amplitude correspond with small thickness of western part of the ophiolitic belt, down to 2km. The graphic of the magnetic anomaly presented in the profile, shows that the ophiolite contact has eastern dips with an angle about 45^o. This interpretation demonstrates the covering character of the ophiolite belt in Mirdita zone, under which lie directly a nappe composed of volcano-sedimentary and tectonic melange formations, as well as the nappe of the Krasta-Cukali zone below (Prenjasi E. et al. 1982). Such geological setting of the nappe character of the ophiolite belt comes from the fact that, the seismological studies have not proved the presence of any deep fracture between Mirdita and the Krasta-Cukali zones.

The separation of the gravity and the magnetic anomalous belts in the Shengjergji flysch's corridor, present another argument in favour of nappe character of ophiolites and the presence of Diber-Elbasan-Vlora transversal fracture. In the Shengjergji flysch corridor no magnetic anomalies are fixed, which would testify to the absence of ultrabasic rocks beyond the east of massif's margins and under the flysch deposits. The Bouguer anomaly in this region is due to the presence of a limestone anticline under the flysch. Vertical electrical soundings have revealed that the flysch deposits have a thickness of (2000–2500)m.

Gashi zone (G). This zone continues into the Durmitory zone of the Dinarides beyond the Albanides. It consists of metamorphic rocks, terrigeneous rocks, limestone, metamorphic volcanites, and basic intermediate and acidic rocks.

External Albanides

The tectonic zones of the External Albanides outcrop chiefly in the western part of Albania.

Alps zone (A) is analogue with the Parnas zone in Hellenides and it continues with High Karst in Dinarides. Sandstone and the conglomerates of Permian are the oldest rocks, which outcrop in this zone. In general, the Alps represent limestone monoclines, as well as smaller anticlines in their background. A regional gravity minimum extends on the Alps zone.

Krasta-Cukali zone (KC), continues in the Pindos zone in Helenides and in Budva zone of the Dinarides. It is divided into two subzones:

Cukali subzone: extends in the north of the zone question. It is composed of Triassic-Cretaous carbonate rocks, some middle Triassic effusive rocks and few radiolarites on the top of Upper Jurassic. These rocks are covered by the Maastrichtian-Paleocene-Eocene flysch. The Cukali subzone represents a big anticline, with small folds. The Alps and Mirdita zones overthrust this subzone.

Krasta subzone: which lies from Shkodra in the North to Leskoviku in the south-east. In this subzone three formations are outcroped: the Albian-Cenomanian early flysch, Senonian limestone serie and Maastrichtian – Eocene flysch. The flysch of Krasta subzone appears as a tectonic windoww even in Shen Gjergji corridor, between two ophiolitic belt parts.

Kruja zone (Kr), continues into the Dalmate zone in Dinarides and in to the Gavroro one in Hellenides. The Kruja zone consists of a series of anticline structures with Cretaceous-Eocene carbonate cores of neritic limestones; dolomitic limestones and dolomites covered with Eocene to Oligocene flysch deposits. In some of the structures, Tortonian molasses overlies transgressively the carbonate rocks, while in other structures; the Burdigalian marls transgresses over the flysch section. The flysch and limestone section plunge down to 10 km, where they are underlain by the Triassic evaporite formations. The main folding of this zone took place in Middle Oligocene and Lower-Middle Miocene. Anticlines are linear with a length of (20-30)km. Anticlines are asymmetric and their western flanks are separated from disjunctive tectonics**.**

Ionian zone (Io) extends in the southwestern part of Albania. This is the biggest zone of the External Albanides and has been developed as a deep pelagic trough since the upper Liassic. The upper Triassic evaporites are the oldest rocks of this zone. Over this formation lies a thick sequence composed of upper Triassic- lower Jurassic dolomite limestone and Jurassic-Cretaceous-Paleogene pelagic cherty limestone. The limestones are covered by Paleogene flysch, Aquitanian flyschoidal formation, section of Burdigalian-Langhian and partially of Serravalian-Tortonian that mainly fill the synclinal belts. Burdigalian deposits often lie unconformly on anticline belts. This has brought about a setting of a two tectonic stages architecture.

The Liassic rifting and later folding phases have affected the External Albanides including the Ionian zone, where have formed the three following structural belts:

a) **The Berati anticline belt,** in the eastern part of the zone.

b) **The Kurveleshi anticline belt,** in the central part of the zone.

c) **The Çika anticline belt,** which represents the western edge of the Ionian zone.

Integrated geological-geophysical data show the presence of many anticline carbonate structures often seated with flysch deposits inside these tectonic belts (Plate 5). These structures are fractured by longitudinal tectonic faults along their western flanks, which go up to thrusting of 5-6 km horizontal displacement [Prenjasi E. 1992]. Two main tectonic styles are distinguished in the Ionian zone: Duplex tectonics and imbricate one. The backthrust faults have happened owing to retrotectonic phenomenon. The regional tectonic faults condition the geodynamic evolution of the Ionian zone. These faults have separated the Ionian basin in several units, since rifting time of lower and middle Jurassic. The periodical tectonic revitalizations of the regional faults have played an important role on overthrusting phenomenon, too. The regional reflection seismic lines across the Ionian zone show that the underlying limestones of the southern Adriatic basin and Sazani Zone has taken place during the structuring process of the Ionian zone, from upper Oligocene to Langhian (Plate 5).

Sazani zone is the eastern continuation of Apulian platform. A thick Cretaceous-Oligocene dolomite and limestone section build up this zone. Marl deposits of Burdigalian lay trangressively on the carbonate formation.

Peri-Adriatic Depression. This unit covers transgresively considerable part of the Ionian, Sazani and Kruja tectonic zones. This is a foredeep depression filled with middle Miocene to Pliocene molasses, mainly covered by Quaternary deposits (Plate 5). The thickness of the molasses increases from southeast to northwest, reaching 5000m. Sandstone-clay deposits of Serravalian and Tortonian are placed trangressively over the older ones, down to the limestone creating a two-stage structure (Plate 5).

